



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

www.qpz.gov.al

Nr.128

4 gusht

2008

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr.9971 datë 28.7.2008	Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Austrisë, për realizimin e një sistemi kompjuterik për Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile në Shqipëri”	5627
Ligj nr.9972 datë 28.7.2008	Për ratifikimin e “Kontratës koncesionare “Për prodhimin dhe shpërndarjen e kartave të identitetit dhe të pasaportave elektronike” ndërmjet Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe grupimit të SAGEM Securite e Fondit Shqiptaro-Amerikan të Ndërmarrjeve”	5634
Ligj nr.9973 datë 28.7.2008	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8025, datë 9.11.1995 “Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese”	5634
Ligj nr.9974 datë 28.7.2008	Për kontratën e riblerjes së titujve	5637
Ligj nr.9975 datë 28.7.2008	Për taksat kombëtare	5640
Dekret nr.5815 datë 25.7.2008	Për emërimin e Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë	5649
Dekret nr.5817 datë 25.7.2008	Për lejim lënie të shtetësisë shqiptare	5650
Dekret nr.5845 datë 29.7.2008	Për emërimin e rektorit të Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës	5651

Vendim i KM nr.1045, datë 16.7.2008	Për trajtimin e kredive të transferuara nga bankat e nivelit të dytë, me kapital tërësisht shtetëror, në Agjencinë e Trajtimit të Kredive, kriteret dhe kushtet për ndryshimin e marrëveshjes së kredisë, si dhe procedurat e marrjes në pronësi të pasurive të lëna si garanci ose jo nga huamarrësit, të administrimit, shitjes dhe dhënies me qira ose me enfiteozë të këtyre pasurive	5652
Vendim i KM nr.1046, datë 16.7.2008	Për kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Tipografia Ushtarake sh.a. “Shtypshkronjës së letrave me vlerë”, Tiranë, të disa reparteve dhe të një trualli funksional	5654
Vendim i KM nr.1047, datë 16.7.2008	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.170, datë 25.4.2002 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e procedurave dhe kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve, për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar	5656
Vendim i KM nr.1048, datë 16.7.2008	Për disa ndryshime në vendimin nr.153, datë 7.4.2000 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar	5658
Vendim i KM nr.1049, datë 16.7.2008	Për rritjen e fondeve të mbrojtjes sociale	5661
Vendim i KM nr.1050, datë 21.7.2008	Për furnizimin e anijeve të peshkimit me gazoil, pa akcizë	5661
Vendim i KM nr.1051, datë 16.7.2008	Për miratimin e publikimin zyrtar të nomenklaturës së kombinuar të mallrave	5664
Vendim i KM nr.1053, datë 23.4.2008	Për disa ndryshime në vendimin nr.787, datë 14.12.2005 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave dhe të masës së ndihmës ekonomike”	5665

LIGJ
Nr.9971, datë 28.7.2008

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË AUSTRISË, PËR REALIZIMIN E NJË SISTEMI KOMPJUTERIK PËR REGJISTRIN KOMBËTAR TË GJENDJES CIVILE NË SHQIPËRI”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Austrisë, për realizimin e një sistemi kompjuterik për Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile në Shqipëri”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5858, datë 31.7.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë
Bamir Topi

MARRËVESHJE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË AUSTRISË MBI
REALIZIMIN E NJË SISTEMI KOMPJUTERIK PËR REGJISTRIN KOMBËTAR TË
GJENDJES CIVILE NË SHQIPËRI

Kryer sot ndërmjet Qeverisë së Republikës së Austrisë përfaqësuar nga Ministri i Brendshëm përfaqësuar nga Departamenti IV/SU-ZMR Hahngasse 8/28 1090 Vienna që më poshtë do të quhet “Kontraktuesi”

dhe

Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë përfaqësuar nga Ministri i Brendshëm që më poshtë do të quhet “Autoriteti Kontraktor”.

Neni 1

Qëllimi

Kjo Marrëveshje ka për qëllim realizimin e një sistemi të plotë kompjuterik operacional *online* për Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile në Shqipëri. Për këtë arsye, Kontraktuesi do të vërë në dispozicion të Autoritetit Kontraktor një paketë programi kompjuterik të quajtur “Varianti ZMR”, i cili do të përfshijë programin kompjuterik austriak për zbatimin e Sistemit të Regjistrimit; nga ana tjetër, Kontraktuesi do të zbatojë ndryshimet e nevojshme për funksionimin e duhur të një sistemi të plotë kompjuterik operacional *online* për Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile në Shqipëri. Një përshkrim i programit kompjuterik të “Variantit ZMR” jepet në aneksin A.

Neni 2

Objekti

Objekti i Marrëveshjes do të jetë realizimi i një sistemi të plotë kompjuterik operacional online për Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile në Shqipëri.

Neni 3 **Të drejtat**

1. Autoriteti Kontraktor do të ketë të drejta të plota përdorimi mbi bazën e dispozitave të kësaj Marrëveshjeje: Autoriteti Kontraktor do të ketë të drejtën e përdorimit të pakufizuar në kohë në lidhje me paketën e programit kompjuterik të quajtur “Varianti ZMR”, i cili do të përfshijë programin kompjuterik austriak për zbatimin e Sistemit të Regjistrimit. Përdorimi i “Variantit ZMR”, ose i pjesëve të veçanta të tij, do të kryhet në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje, për realizimin e një sistemi të plotë kompjuterik operacional për Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile në Shqipëri.

2. Autoritetit Kontraktor do t’i jepet një e drejtë përdorimi ekskluzive, e pakufizuar në kohë dhe përmbajtje në lidhje me ndryshimet e nevojshme për zbatimin në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile të Shqipërisë.

3. Të gjitha ndryshimet që nevojiten për t’i dhënë Autoritetit Kontraktor një sistem funksional dhe operacional, do të përcaktohen në një fletë me specifikimet teknike që do të përpilohen në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktor (shiko nenin 7 detyrimet).

Neni 4 **E drejta e autorit**

Çdo transferim, me ose pa shpërblim, i “Variantit ZMR” si pjesë e Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile të çdo person fizik ose juridik, në veçanti të çdo organizatë qeveritare ose joqeveritare jashtë Shqipërisë, në çdo lloj forme, është i ndaluar. Të gjitha të drejtat e autorësisë në lidhje me këtë program (shiko aneksin A1) qëndrojnë te Kontraktuesi.

Neni 5 **Gjuha**

Gjuha e projektit është anglishtja. Autoriteti Kontraktor do të jetë përgjegjës për të gjitha përkthimet në gjuhën kombëtare të Autoritetit Kontraktor, si GUI (paraqitja vizuale e përdoruesit), mesazhet e defekteve, mesazhet e sistemit etj.

Neni 6 **Shërbimet e ofruara**

1. Të gjitha shërbimet që përfshihen në “Variantin ZMR” të përshkruar në aneksin A, duhet të sigurohen nga Kontraktuesi.

2. Marrëveshja përfshin si shërbime kryesore, shërbimet e mëposhtme:

- Raportimin, statistikën siç janë përdorur në sistemin austriak;
- Sigurimin e Portalit Austriak Standard me administrimin bazë të përdoruesit;
- Trajnim dhe dokumentimin e trajnimit për stafin e Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile;
- Rregullat për pastrimin e të dhënave për të dhënat e transferuara;
- Krijimin e një Qendre të Dhënash sipas aneksit C.

3. Autoriteti Kontraktor duhet të caktojë Kontraktuesin, për 2 (dy) vitet në vijim, duke filluar pas testit të pranimit, që do të sigurojë shërbimet për vazhdimin dhe përmirësimin e një sistemi të plotë kompjuterik operacional për Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile në Shqipëri, kundrejt pagesës. Pagesa do të bëhet në shumën totale prej 600 000 eurosh për dy vitet, dhe do të jepet paraprakisht në shuma të barabarta duke filluar nga data 1 janar 2009. Në të kundërt Kontraktuesi nuk mund të përmbushë garancinë. Kontraktori ka të drejtë të përdorë një nënkontraktor për të përmbushur detyrimet e tij.

Neni 7

Detyrimet për bashkëpunim

Detyrime të përgjithshme për bashkëpunim:

Autoriteti Kontraktues do të ndërmarrë të gjitha masat që do të kontribuojnë për një zbatim të suksesshëm të projektit. Kjo do të përfshijë në veçanti furnizimin me të dhëna ose informacion të rëndësishëm për një zbatim të suksesshëm të projektit (informacion mbi statusin e rrjetit në Shqipëri etj.), përcaktimin e partnereve të kontaktit, si dhe vënien në dispozicion të një personeli dhe infrastrukture të përshtatshme.

Detyrime të veçanta për bashkëpunim:

Autoriteti Kontraktor do të vërë në dispozicion personel të përshtatshëm gjatë zbatimit të projektit, në veçanti për përpunimin e fletës së specifikimeve. Ky personel duhet të jetë i pajisur me njohuritë e nevojshme për situata ligjore përkatëse, proceset dhe organizimin e regjistrimit në Shqipëri. Detyrimet e veçanta për bashkëpunim do të përfshijnë në veçanti të gjitha përkthimet në gjuhën kombëtare.

Autoriteti Kontraktor është i detyruar të vërë në dispozicion bazën e të dhënave që disponon ose pjesë të saj në mënyrë që të jetë e mundur të kryhet një testim i mjaftueshëm i sistemit përpara pranimit. Personeli profesional duhet të jetë në gatishmëri për fazën e testimit. Kontraktuesi nuk mund të bëhet përgjegjës për çdo lloj vonese të Autoritetit Kontraktor në lidhje me afatet e projektit.

Neni 8

Zbatimi i projektit

1. Kjo Marrëveshje do të zbatohet për një periudhë 4 (katër) mujore nga data e nënshkrimit. Për arsye të ndryshme, në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje, kjo periudhë mund të zgjatet.

2. Çdo javë (ditë të premte) do të bëhet një vlerësim mbi datat për zbatimin e projektit dhe përmbushja e detyrave në bashkëpunim të ngushtë me Palët. Raporti i situatës do t'i dërgohet Palëve, të cilat vendosin mbi masat e mundshme.

3. Zbatimi do të kryhet në Tiranë/Shqipëri. Shpenzimet e udhëtimit dhe akomodimit do të mbulohen nga secila Palë.

Neni 9

Drejtimi dhe mbikëqyrja e projektit

1. Komiteti Drejtues drejton dhe mbikëqyr projektin. Ky Komitet

- bashkëdrejtohet, me të drejtë vendimmarrje, nga:

1. një përfaqësues i Ministrisë së Brendshme Shqiptare;

2. një përfaqësues i Ministrisë së Brendshme Austriake;

- dhe përbëhet nga:

1. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile në Shqipëri 2 anëtarë;

2. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile Austriake 2 anëtarë;

3. Drejtuesi i asistencës teknike të projektit BE-OSBE 1 anëtar;

4. Përfaqësuesi i Statistic Norway 1 anëtar;

5. Koordinator i projektit 1 anëtar;

6. Menaxheri i projektit 1 anëtar.

Këta anëtarë të Komitetit Drejtues luajnë vetëm rolin këshillues. Komiteti Drejtues mbledhet jo më pak se një herë në muaj me kërkesë të Palëve.

2. KOORDINATORI I PROJEKTIT për Autoritetin Kontraktor, është Drejtori i Përgjithshëm i Gjendjes Civile. Ai do të shërbejë si pikë kontakti kryesor për Autoritetin Kontraktor, do të jetë përgjegjës për zbatimin në kohë të të gjitha detyrave përkatëse të projektit, do të hartojë raportin, (shikoni neni 8/2), në bashkëpunim me Menaxherin e projektit të Kontraktuesit, do të koordinojë të gjitha veprimtaritë, si dhe do të jetë përgjegjës për sigurimin në kohë të të gjitha dokumenteve të nevojshme.

3. MENAXHERI I PROJEKTIT për Kontraktuesin, do të caktohet nga përfaqësuesi i Ministrisë së Brendshme të Austrisë. Në rast se zëvendësohet, pasardhësi do të caktohet brenda 8 ditëve. Menaxheri i projektit do të përgatisë një raport javor në bashkëpunim me koordinatoren e

projektit të Autoritetit Kontraktor dhe do të jetë i detyruar të raportojë respektivisht, të propozojë masa të nevojshme dhe të ndryshojë kërkesën për përfaqësuesin e Autoritetit Kontraktor dhe Kontraktuesit.

Neni 10 **Ndryshimet teknike**

Komiteti Drejtues miraton propozimet teknike. Në çdo rast propozimet për ndryshime teknike duhet të garantojnë suksesin e projektit dhe përfundimin në kohë të tij. Në asnjë rast propozimet nuk duhet të cenojnë funksionalitetin e sistemit.

Neni 11 **Shqyrtimi dhe pranimi i fletëve të specifikimeve dhe sistemit**

1. Kontraktuesi paraqet fletët e specifikimeve sipas planit të projektit që paraqitet në aneksin B, në çdo rast jo më vonë se 2 muaj nga nënshkrimi i Marrëveshjes. Autoriteti Kontraktor është i detyruar të miratojë, me shkrim, fletët e specifikimeve brenda 5 ditëve pas paraqitjes. Në rast të ndonjë defekti të veçantë, Autoritetit Kontraktor i jepet e drejta të kërkojë një rregullim të defekteve nga Kontraktuesi, i cili duhet të pranohet siç përshkruhet më lart. Nëse brenda afatit kohor nuk paraqitet asnjë kërkesë për ndryshim, fleta e specifikimeve do të konsiderohet e miratuar. Defekte të vogla nuk duhet të konsiderohen si arsye për të refuzuar miratimin e fletës së specifikimeve.

2. Shqyrtimi dhe pranimi i sistemit duhet të kryhen në formën e një testi pranimi, i cili duhet të përcaktohet së bashku me fletën e specifikimeve.

Defekte të rëndësishme, të parëndësishme dhe të vogla, janë kategorizuar si më poshtë:

- a) defektet e rëndësishme parandalojnë/rrezikojnë zbatimin e programit të dhënë;
- b) defektet e parëndësishme ndërhyjnë qartë në zbatimin e duhur pa e rrezikuar atë;
- c) defektet e vogla ndërhyjnë qartë në zbatimin e duhur, por shmangen nga standardi teknikisht i kërkuar.

Pranimi konsiderohet si i dështuar nëse një prej situatave të poshtëshënuar ndeshet me;

- secilin prej defekteve të rëndësishme;
- të paktën pesë defekte të parëndësishme; apo
- njëzet të vogla.

3. Pranimi do të deklarohet në një dokument të shkruar, i cili duhet të nënshkruhet nga Koordinatori i projektit dhe Menaxheri i projektit dhe të miratohet nga Komiteti Drejtues. Nëse pranimi dështon, një afat përfundimtar për sqarim duhet të fillojë me një bashkëpunim të ngushtë ndërmjet Palëve. Pas skadimit të kohës, pranimi duhet të ripërsëritet siç përshkruhet më lart. Nëse nuk ka marrëveshje për defektet ekzistuese, të dyja Palëve u jepet e drejta për të caktuar një ekspert me qëllim për të gjykuar defektet.

4. Pranimi do të deklarohet në një dokument të shkruar, i cili duhet të nënshkruhet nga Koordinatori i projektit dhe Menaxheri i projektit dhe të miratohet nga Koordinatori i projektit. Komiteti Drejtues do të japë vendimin brenda 14 ditëve. Nëse pranimi dështon, një afat për sqarim duhet të vendoset në bashkëpunim të ngushtë ndërmjet Palëve. Pas skadimit të kohës, pranimi duhet të ripërsëritet siç përshkruhet më lart. Nëse nuk ka marrëveshje për defektet ekzistuese, të dyja Palëve u jepet e drejta për të caktuar një ekspert me qëllim për të gjykuar defektet. Pas përfundimit të pranimit nga Komiteti Drejtues të gjitha pjesët e këtij sistemi të plotë operacional të zbatuar i kalohen automatikisht Autoritetit Kontraktues si një program i tërë.

Neni 12 **Pagesa**

1. “Varianti ZMR”, i vihet në dispozicion Autoritetit Kontraktor pa pagesë.

2. Pagesa për shërbimet e kryera nga Kontraktori, në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje është 1 300 000 euro, duke përfshirë taksën e TVSH-së dhe ato doganore në Shqipëri.

Neni 13 **Mënyra e pagesës**

Pagesa duhet të kryhet në 6 etapa, si më poshtë vijon:

- | | |
|---|---------------|
| 1. Pas nënshkrimit të Marrëveshjes | 300 000 euro; |
| 2. Në fund të muajit të parë | 200 000 euro; |
| 3. Në fund të muajit të dytë | 200 000 euro; |
| 4. Në fund të muajit të tretë | 200 000 euro; |
| 5. Pas përfundimit të testimit | 200 000 euro; |
| 6. Pas pranimit nga Autoriteti Kontraktor | 200 000 euro. |

Në të gjitha rastet pagesa duhet të bëhet jo më vonë se 7 ditë nga momenti i pranimit, në Bankën _____, në numrin e llogarisë _____.

Neni 14 **Garancia**

1. Garancia duhet të aktivizohet pas kohës së pranimit, për një periudhë kohe prej 2 vitesh për modulet e pranuar.

2. Autoriteti Kontraktor është i detyruar të dokumentojë defektet e përcaktuara dhe në mënyrë të menjëhershme të informojë Kontraktuesin me shkrim. Kontraktuesi është i detyruar të rregullojë defektet e rëndësishme dhe të parëndësishme të aplikimit siç përshkruhen në nenin 11, brenda 7 ditëve. Në rast se sistemi pushon së funksionuari kjo kohë nuk duhet të jetë më tepër se ditë pune (Nga e hëna deri të premte). Të gjithë defektet e tjera duhet të trajtohen mbi bazat e një Marrëveshje mirëmbajtjeje.

3. Garancia nuk është e vlefshme, në veçanti, nëse paketa software “Varianti ZMR” përdoret në mënyrë të gabuar në një mjedis me defekt ose të papajtueshëm nga Autoriteti Kontraktor, si dhe në rast të miratimeve të paautorizuara dhe/ose ndryshime të paketës së software.

Neni 15 **Kompensimi i dëmeve**

1. Përgjegjësia e Kontraktuesit, në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje, duhet të kufizohet me qëllimin ose neglizhencën në një shume prej 1 300 000 eurosh.

2. Palët janë përgjegjëse për çdo dëm të shkaktuar, nga stafi i tyre përkatës, me qëllim apo si rezultat i neglizhencës së madhe.

Neni 16 **Anulimi i Marrëveshjes**

Anulimi i marrëveshjes duhet të kufizohet vetëm nëse ndodhin rastet e mëposhtme:

- a) në rast të vonësës së pagesës;
- b) në rast të dështimit për të përmbushur një detyrim për më tepër se 40 ditë, që është atribut ekskluziv i Kontraktuesit;
- c) një shkelje e rëndë e konfidencialitetit.

Neni 17 **Konfidencialiteti**

1. Në këtë Marrëveshje, të dyja Palët duhet të japin informacion i cili duhet të jetë i mbrojtur.

2. Në mënyrë që të zgjidhen çështje të ndërlidhura, duhet të bihet dakord mbi hapat e mëposhtëm:

a) Informacionet e fshehta në kushtet e kësaj Marrëveshjeje duhet të jenë teknike, komerciale ose që kanë të bëjnë me organizimin, pavarësisht nga gjendja fizike (materiale ose jomateriale). Kjo gjithashtu, duhet të përfshijë të gjitha dokumentet duke përfshirë makinat lexuese të informacionit dhe dokumentet, softet, objektet, materialin e mëtejshëm etj., në formë të shkruar, verbale ose forma të tjera. Të gjitha analizat, studimet, përfundimet, si dhe dokumentet, marrëveshjet dhe informacioni i mëtejshëm që janë shtjelluar për Autoritetin Kontraktor duhet të konsiderohen sekrete, përveç kur Palët bien dakord që informacioni të bëhet publik.

b) I gjithë informacioni sekret, i cili është i hapur për Autoritetin Kontraktor ose është berë i

mundur për Autoritetin Kontraktor në një mënyrë të ndryshme, duhet të mbahet konfidencial ndaj personave të tretë. Hyrja në këtë informacion duhet të lejohet vetëm për arsye të implementimit të kësaj Marrëveshjeje. Kontraktuesi duhet t'ua japi këtë informacion vetëm stafit, i cili kërkon informacionin për qëllime të caktuara ose që është e detyruar nga kushtet e kontratës, ose nga një marrëveshje tjetër e shkruar për ta mbajtur këtë informacion tepër konfidencial.

c) Përsa i përket informacionit sekret, Autoriteti Kontraktues duhet të garantojë sa më poshtë:

- Ruajtje të klasifikuar, në përputhje me:

a) për Autoritetin Kontraktor: ligjin nr.9887, datë 10.3.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale";

b) për Kontraktuesin: ligji i DSG 2000.

- Palët janë të detyruara të informojnë menjëherë me shkrim për humbjen e ndonjë informacioni. Kjo duhet të jetë gjithashtu e vlefshme për humbjet që kanë të bëjnë me vjedhjen, grabitjen, plaçkitjen etj.

- Gjatë ruajtjes dhe transportit, i gjithë informacioni duhet të jetë i mbrojtur nga inspektimet nga persona të tretë të paautorizuar, duke përdorur masa që i korrespondojnë teknologjisë më të fundit.

3. Detyrimi i konfidencialitetit kontraktual do të mbetet i paprekur nga anulimi i Marrëveshjes.

Neni 18

Përfundimi nga taksat

Të gjitha pajisjet dhe shërbimet, që do të blihen dhe kryhen brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë (nga Kontraktori ose nga nënkontraktori i tij i caktuar), do të përfundohen nga detyrimet doganore në Shqipëri.

Neni 19

Ligji i aplikueshëm dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Palët bien dakord të zgjidhin mosmarrëveshjet me mirëkuptim ose në rrugë diplomatike paraprakisht. Në rast të ndonjë mosmarrëveshjeje, e cila mund të lindë nga dhe në lidhje me vlefshmërinë, fuqinë, interpretimin dhe zgjidhjen e kësaj Marrëveshjeje, e cila nuk mund të zgjidhet me mirëkuptim reciprok ndërmjet Palëve do të zgjidhet përfundimisht nëpërmjet Arbitrazhit Ndërkombëtar në përputhje me rregullat e Arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë (ICC), nga një apo tre arbitra, që do të emërohen sipas rregullave të lartpërmendura dhe ligji zviceran do të jetë i aplikueshëm për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve. Vendi i Arbitrazhit do të jetë Zyrih, Zvicër dhe gjuha e arbitrazhit do të jetë anglishtja.

Neni 20

Parashikime të tjera

1. Të gjitha ndryshimet në kalendarin e aktiviteteve të kësaj Marrëveshjeje duhet të jenë të nënshkruara nga personat e autorizuar të Palëve dhe do të jenë të miratuara nga Komiteti Drejtues.

2. Nëse njëra nga dispozitat e kësaj Marrëveshjeje bëhet e pavlefshme, të gjitha dispozitat e kësaj Marrëveshjeje do të mbeten të vlefshme. Në një rast të tillë, Palët do të bien dakord të bashkëpunojnë sa më mirë të jetë e mundur, në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje për të gjetur një zgjidhje.

3. Kjo Marrëveshje do të bëhet në dy kopje në gjuhën angleze, një kopje për secilën Palë.

Neni 21

Hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në datën e marrjes së njoftimit të fundit me shkrim me anë të të cilit Palët Kontraktuese njoftojnë njëra-tjetrën në rrugë diplomatike që procedurat e tyre të brendshme ligjore të nevojshme për hyrjen në fuqi kanë përfunduar.

ANEKSI A

AI. Varianti ZMR

- Përshkrim i shkurtër i variantit ZMR

- Kontroll funksional ZMR

A 2 Miratimi i Regjistrit Themeltar Civil

Kontroll Funksional i Regjistrit Themeltar Civil

Hyrje funksionale e kontrollit – komponent opsional

Certifikata për kontrollin funksional – komponent opsional

ANEKSI B

- Planet për projektin

ANEKSI C

- Qendra e të dhënave dhe mbështetja operationale

LIGJ

Nr.9972, datë 28.7.2008

PËR RATIFIKIMIN E “KONTRATËS KONCESIONARE “PËR PRODHIMIN DHE SHPËRNDARJEN E KARTAVE TË IDENTITETIT DHE TË PASAPORTAVE ELEKTRONIKE” NDËRMJET MINISTRISË SË BRENDSHME TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE GRUPIMIT TË SAGEM SECURITE E FONDIT SHQIPTARO-AMERIKAN TË NDËRMARRJEVE”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Kontrata koncesionare “Për prodhimin dhe shpërndarjen e kartave të identitetit dhe të pasaportave elektronike” ndërmjet Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe grupimit të SAGEM Securite e Fondit Shqiptaro-Amerikan të Ndërmarrjeve”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekreten nr.5859, datë 31.7.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë
Bamir Topi**

**LIGJ
Nr.9973, datë 28.7.2008**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR.8025,
DATË 9.11.1995 “PËR MBROJTJEN NGA RREZATIMET JONIZUESE”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Në ligjin nr.8025, datë 9.11.1995 “Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese”, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Neni 1 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 1

Ky ligj përcakton kushtet e mbrojtjes dhe të sigurisë nga rrezatimet jonizuese, për të gjitha veprimtaritë që kryhen me lëndë radioaktive dhe pajisje rrezatuese, me qëllim mbrojtjen e punonjësve të ekspozuar profesionalisht ndaj rrezatimeve, të popullatës dhe mjedisit, në tërësi, nga rreziqet e mundshme të rrezatimeve, si dhe sigurimin e materialeve radioaktive, duke shfrytëzuar, në maksimum, të mirat që vijnë nga përdorimi i rrezatimeve jonizuese.”.

Neni 2

Neni 3 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 3

Subjekt i këtij ligji është çdo person fizik ose juridik, i cili:

- a) zotëron, riparon, mirëmban, transferon, merr, përdor, fabrikon ose instalon pajisje rrezatuese, të cilat transmetojnë rrezatime jonizuese dhe përmbajnë komponentë, që veprojnë me një diferencë potenciale më shumë se 5 kV;
- b) kryen kërkime radiologjike, punime minerare, prodhim, bluarje, ekstraktim, pasurim, shitje, transferim, import-eksport, dhënie me qira dhe ruajtje të lëndëve radioaktive;
- c) trajton, prodhon, manovron, përdor dhe ruan mbetje radioaktive, ushqime dhe produkte të tjera, të ndotura me lëndë radioaktive;
- ç) kontrollon, nga ana teknike dhe funksionale, aparaturat, burime të rrezatimit jonizues.”.

Neni 3

Neni 5 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 5

Personat fizikë ose juridikë, të pajisur me licencë, kanë përgjegjësi ligjore për mbrojtjen, sigurinë dhe sigurimin nga burimet e rrezatimit jonizues, si dhe për zbatimin e dispozitave të parashikuara në këtë ligj e në akte të tjera, të dala në zbatim të tij. Personat fizikë ose juridikë, përdorues të burimeve të rrezatimit jonizues, janë të detyruar të kalojnë në proces kontrolli teknik aparaturat, burimet e rrezatimit jonizues, sipas kriterëve të parashikuara në rregulloren përkatëse.”.

Neni 4

Neni 6 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 6

1. Pranë Ministrisë së Shëndetësisë krijohet Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet, si autoriteti përgjegjës kombëtar rregullator, i cili mbikëqyr dhe siguron zbatimin e dispozitave të këtij ligji dhe të akteve të tjera ligjore e nënligjore në fushën e mbrojtjes nga rrezatimet.

2. Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet kryesohet nga Ministri i Shëndetësisë dhe përbëhet nga 7 anëtarë.

3. Në varësi të Komisionit të Mbrojtjes nga Rrezatimet ngrihet zyra e mbrojtjes nga rrezatimet, si njësi ekzekutive. Kryetari i kësaj zyre është dhe sekretar i komisionit.

4. Përbërja, organizimi, funksionimi dhe mënyra e shpërblimit të anëtarëve të Komisionit të Mbrojtjes nga Rrezatimet përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 5

Në nenin 7 bëhen këto ndryshime:

a) Në shkronjën “a”, fjala “nxjerr” zëvendësohet me fjalën “harton”.

b) Shkronja “ë” ndryshohet si më poshtë:

“ë) bashkërendon punën me institucionet e specializuara, për kalibrimin e pajisjeve të rrezatimit jonizues, dozimetritë personale, monitorimin e mjedisit, për kontrollin mjekësor të punonjësve të ekspozuar profesionalisht, trajnimin e personelit me ekspertë të pavarur për veprimtari me rrezatime jonizuese, si dhe me institucione të tjera, sipas nevojave, në bazë të marrëveshjeve të mirëkuptimit për zgjidhjen e problemeve kombëtare në fushën e mbrojtjes nga rrezatimi.”.

Neni 6

Në nenin 8, pas shkronjës “dh” shtohet shkronja “e” me këtë përmbajtje:

“e) zyra për mbrojtjen nga rrezatimet mban inventarin kombëtar të burimeve të rrezatimit jonizues.”.

Neni 7

Neni 9 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 9

1. Rregulloret për mbrojtjen nga rrezatimet, për sigurinë dhe sigurimin e burimeve të rrezatimit jonizues, të hartuara nga Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Komisioni për Mbrojtjen nga Rrezatimet miraton kodet e praktikave, udhëzimet dhe norma të tjera, të lidhura me mbrojtjen nga rrezatimet, sigurinë dhe sigurimin e burimeve të rrezatimit jonizues.”.

Neni 8

Në nenin 10, paragrafi i parë ndryshohet si më poshtë:

“Shkelja e dispozitave të parashikuara në nenet 4 e 5 të këtij ligji, kur nuk përbën veprë penale, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 100 000 lekë deri në 300 000 lekë.”.

Neni 9

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.5860, datë 1.8.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë
Bamir Topi**

LIGJ

Nr.9974, datë 28.7.2008

PËR KONTRATËN E RIBLERJES SË TITUJVE

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

1. Qëllimi i këtij ligji është të krijojë kuadrin e nevojshëm për lidhjen dhe zbatimin e marrëveshjeve të riblerjeve dhe të anasjellta të riblerjeve të titujve në formën e kontratës së riblerjes së titujve, në të cilën të paktën njëra nga palët është e licencuar për të ushtruar veprimtari bankare ose veprimtari financiare jobankare, duke rritur efikasitetin dhe qëndrueshmërinë afatgjatë të zhvillimit të tregjeve financiare në Republikën e Shqipërisë.

2. Ligji synon zhvillimin e mëtejshëm të parimeve të përgjithshme të legjislacionit shqiptar për lidhjen, ekzekutimin dhe zgjidhjen e kontratave, nëpërmjet përcaktimit të kushteve, pasojave dhe procedurave të veçanta të ekzekutimit të detyrueshëm, në rast të mospërbushjes së detyrimeve të kontratës së riblerjes së titujve.

Neni 2

Objekti

1. Objekti i këtij ligji është përcaktimi i të drejtave dhe detyrimeve të palëve në kontratën e riblerjes së titujve, si dhe i kushteve për zbatimin e detyrueshëm të tyre si ndërmjet vetë palëve kontraktore, ashtu dhe nga palët e treta.

2. Për ato çështje që nuk rregullohen nga ky ligj, palët e kontratës së riblerjes së titujve dhe marrëdhëniet juridike që lindin ndërmjet tyre do t'u nënshtrohen dispozitave përkatëse të Kodit Civil dhe dispozitave të tjera juridike në fuqi.

3. Në rast mospërputhjeje me ligjet në fuqi, ky ligj mbizotëron mbi të gjitha ligjet e tjera referuese të zbatueshme.

Neni 3

Nocioni i kontratës

1. Kontrata e riblerjes së titujve konsiderohet kontrata, nëpërmjet së cilës “riblerësi” transferon te “rishitësi” pronësinë e një titulli ose sasi titujsh në një datë dhe për një çmim fillestar të caktuar, ndërsa ky i fundit detyrohet që, në përfundim të afatit të përcaktuar në kontratë ose me kërkesë të riblerësit, t'i ritransferojë këtij të fundit pronësinë mbi të njëjtin titull ose sasi titujsh, të të njëjtit lloj ose të llojit të ngjashëm, përkundrejt pagesës së një çmimi të ri.

2. Çmimi i ri i riblerjes/rishitjes së titujve mund të jetë i barabartë me çmimin fillestar të shitjes/blerjes së tyre, ose mund të shtohet apo të pakësohet përkundrejt këtij të fundit në masën ose mënyrën e caktuar paraprakisht nga palët në kontratë, në çastin e lidhjes së saj.

3. Kontrata e riblerjes së titujve lidhet gjithmonë me shkrim ndërmjet palëve.

Neni 4

E drejta për zëvendësimin e titujve

1. Përfundimisht nga përcaktimi i nenit 3 të këtij ligji, palët mund të parashikojnë në kontratë të drejtën e riblerësit që të zëvendësojë titujt që përbëjnë objektin e kontratës së riblerjes së titujve me tituj të tjerë.

2. Modalitetet e zëvendësimit të titujve, që përbëjnë objektin e kontratës së riblerjes së titujve, përcaktohen me marrëveshje të palëve në kontratë.

3. Zëvendësimi i titujve, sipas pikës 1 dhe 2 të këtij neni, nuk përbën një kontratë të re ndërmjet palëve.

Neni 5

Objekti i kontratës

1. Objekt i kontratës së riblerjes së titujve mund të jenë të gjitha llojet e titujve të emetuar, sipas mënyrës së parashikuar në legjislacionin në fuqi për titujt.

2. Të njëjtët tituj nuk mund të jenë njëkohësisht objekt i më shumë se një kontrate të riblerjes së titujve, me përjashtim të rasteve kur është parashikuar ndryshe me akt nënligjor të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare ose të Bankës së Shqipërisë.

Neni 6

Të drejtat mbi titujt

Kur titujt që përbëjnë objektin e kontratës mbartin të drejta vote, këto të drejta, përveç të drejtave të tjera që burojnë nga pronësia mbi titujt, i përkasin rishitësit gjatë gjithë kohëzgjatjes së ekzekutimit të kontratës.

Neni 7

Kalimi i të drejtave dhe detyrimeve

1. Kontrata e riblerjes së titujve është e paefektshme, në qoftë se nuk shoqërohet me transferimin dhe ritransferimin e pronësisë së titujve, që përbëjnë objektin e saj.

2. Në kontratën e riblerjes së titujve, si në rastin kur objektin e saj e përbëjnë titujt e dematerializuar (*book-entry*), ashtu dhe në rastin kur objektin e saj e përbëjnë titujt e emetuar në formë fizike (me certifikatë), kalimi i pronësisë së titujve është i paefektshëm, në qoftë se nuk shoqërohet me rregullimet përkatëse në llogari ose dorëzimin fizik të tyre.

3. Në rastin kur objekt i kontratës së riblerjes së titujve janë titujt e shtetit shqiptar, përfshirë dhe ata të emetuar në formë fizike (me certifikatë), pagesa e çmimit dhe transferimi i pronësisë së titujve kryhen nëpërmjet sistemit të regjistrimit në llogari për titujt e shtetit, të mbajtur nga agjenti fiskal i shtetit.

KREU II

MOSPËRMBUSHJA E DETYRIMEVE DHE MJETET LIGJORE PËR EKZEKUTIMIN E TYRE

Neni 8

Mjetet ligjore për ekzekutimin e detyrueshëm të kontratës

1. Në qoftë se njëra nga palët nuk paguan çmimin e blerjes ose të riblerjes së titujve, ose nuk e paguan atë në masën dhe mënyrën e përcaktuar në kontratë, pala tjetër ka të drejtë të shesë vetë dhe menjëherë titujt që përbëjnë objektin e kësaj kontrate.

2. Në qoftë se çmimi i realizuar nga shitja e titujve është më i ulët se shuma e çmimit përkatës të përcaktuar në kontratë për titujt me shpenzimet e kryera për realizimin e shitjes së tyre, ekzekutimi i detyrueshëm, sipas pikës 1 të këtij neni, nuk paragjykon të drejtën e palës kreditore për të kërkuar nga pala tjetër edhe pagesën për diferencën e rezultuar.

3. Në qoftë se çmimi i realizuar nga ekzekutimi i detyrueshëm, sipas pikës 1 të këtij neni, është më i lartë se shuma e çmimit përkatës të përcaktuar në kontratë për titujt me shpenzimet e kryera për realizimin e shitjes së tyre, pala kreditore mban nga shuma e marrë atë që i nevojiten për përmbushjen e të drejtave të saj dhe mbetjen ia kthen palës debitorë.

4. Ekzekutimi i detyrueshëm i kontratës së riblerjes së titujve mund të realizohet dhe nëpërmjet vënies në ekzekutim të klauzolave ose marrëveshjeve netting, sipas përcaktimeve të neneve 9 dhe 11 të këtij ligji.

Neni 9

Njohja dhe zbatimi i detyrueshëm i marrëveshjeve netting

1. Legjislacioni, gjykatat dhe institucionet e tjera publike ose shtetërore në Republikën e Shqipërisë njohin si të vlefshme ligjërisht dhe sigurojnë ekzekutimin e detyrueshëm të klauzolave ose marrëveshjeve të tipit netting, në rastin kur këto të fundit janë pjesë e kontratës së riblerjes së titujve ose marrëveshjes kuadër (kontratës standard), që rregullon njëkohësisht disa transaksione të tipit repo.

2. Zbatimi i klauzolave ose marrëveshjeve të tipit netting, sipas pikës 1 të këtij neni, është tërësor, duke siguruar zbatimin e secilit kusht të këtyre klauzolave ose marrëveshjeve.

3. Ekzekutimi i detyrueshëm i klauzolave ose marrëveshjeve të tipit netting, sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni, sigurohet edhe në rastin kur ndaj të paktën njëres prej palëve kontraktore në Republikën e Shqipërisë janë hapur procedurat e lidhura me paafësinë paguese, falimentimin, likuidimin, vënien në kujdestari etj.

Neni 10

Mbarimi i kontratës

Nëse afati kohor për përfundimin e kontratës së riblerjes së titujve nuk është përcaktuar, kontrata përfundon pasi të jenë ekzekutuar plotësisht të gjitha detyrimet për ritransferimin të riblerësi të pronësisë së titujve, objekt i kontratës.

Neni 11

Zbatimi i ligjit të huaj dhe përparësia e së drejtës ndërkombëtare

1. Palët mund të përcaktojnë me shkrim në kontratë se kjo e fundit do të rregullohet nga legjislacioni i huaj, si dhe mund t'u nënshtrohet njëkohësisht marrëveshjeve kuadër, kontratave standard, praktikave dhe/ose zakoneve tregtare ndërkombëtare ose kombëtare, të zbatueshme në industrinë bankare.

2. Në rast se përmbajtja e legjislacionit të huaj ose e marrëveshjeve kuadër, kontratave standard, praktikave dhe/ose zakoneve tregtare ndërkombëtare, të zbatueshme për kontratën repo, sipas pikës 1 të këtij neni, bien në kundërshtim me cilëndo dispozitë të këtij ligji ose të ligjeve të tjera të Republikës së Shqipërisë, parashikimet e legjislacionit të huaj ose të marrëveshjeve kuadër, kontratave standard, praktikave dhe/ose zakoneve tregtare ndërkombëtare do të kenë përparësi ndaj dispozitave të këtij ligji ose të ligjeve të tjera të Republikës së Shqipërisë.

Neni 12

Autoriteti rregullator dhe mbikëqyrës

1. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, në përputhje me dispozitat e ligjit nr.9572 datë 3.7.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare" dhe të ligjit për titujt rregullon dhe mbikëqyr veprimtarinë e ushtruar në formën e kontratës së riblerjes së titujve në tregun e tyre.

2. Banka e Shqipërisë, në përputhje me ligjin nr.9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", rregullon dhe mbikëqyr veprimtarinë e ushtruar në formën e kontratës së riblerjes së titujve, në rastet kur kjo veprimtari ushtrohet nga subjektet e licencuara prej saj. Për këtë qëllim Banka e Shqipërisë mund të miratojë kontratën tip të riblerjes së titujve, e cila është e detyrueshme për t'u zbatuar nga subjektet e licencuara prej saj.

Neni 13

Trajtimi kontabël i kontratës së riblerjes së titujve

Ngarkohen Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare dhe Banka e Shqipërisë që, në bashkëpunim me Këshillin Kombëtar të Kontabilitetit, të përcaktojnë me akt nënligjor rregullat për mbajtjen në bilancin e riblerësit të titujve, objekt i kontratës së riblerjes së titujve, në rastet kur në bazë të legjislacionit në fuqi ky i fundit nuk është pronar i tyre.

Neni 14

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekreten nr.5861, datë 1.8.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë
Bamir Topi**

LIGJ

Nr.9975, datë 28.7.2008

PËR TAKSAT KOMBËTARE

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Neni 1 Qëllimi

Ky ligj përcakton llojet e taksave kombëtare, që zbatohen në Republikën e Shqipërisë, nivelin e taksave kombëtare, procedurat e llogaritjes, të arkëtimit dhe transferimit në Buxhetin e Shtetit ose në buxhetin e njësisë të qeverisjes vendore, si dhe detyrimet që kanë agjentët e taksave kombëtare.

Neni 2 Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Taksapagues” është çdo individ, person fizik ose juridik, vendas apo i huaj, i cili është i detyruar të paguajë njërën nga taksat kombëtare, të përcaktuara në këtë ligj.
2. “Taksë” është taksa kombëtare e vendosur me këtë ligj.
3. “Agjent i taksave” është personi, i cili, sipas kërkesave të këtij ligji, është përgjegjës për llogaritjen, arkëtimin dhe transferimin në llogaritë e Buxhetit të Shtetit të të ardhurave nga taksat kombëtare.

Neni 3 Llojet e taksave kombëtare

Taksat kombëtare janë:

1. Taksa portuale.
2. Taksa vjetore e qarkullimit rrugor të mjeteve.
3. Taksa e mjedisit, që përbëhet nga:
 - a) taksa e importimit të automjeteve të përdorura;
 - b) taksa e karbonit për benzinën, benzolin dhe gazoilin;
 - c) taksa për ambalazhet plastike të lëngjeve (bidonë, shishe plastike e kuti të plastifikuara, të të gjitha formave dhe përmasave), të mbushura, të prodhuara në vend dhe të importuara, për produktet si ujë, pije freskuese, lëngje frutash e perimesh, qumësht dhe nënproduktet e tij, vajra ushqimore, vajra lubrifikante dhe detergjentë.
4. Taksa e rentës minerare.
5. Taksa e akteve dhe e pullës.
6. Taksa për regjistrimin e lojërave të fatit, për lotarinë kombëtare, për konkursin për parashikimet sportive, kazinotë dhe për garat sportive që zhvillohen në hipodrom.
7. Taksa e ushtrimit të veprimtarisë së peshkimit.

Neni 4 Niveli i taksave kombëtare

1. Taksa portuale është 1 euro. Kjo taksë paguhet, për çdo prekje, për të gjitha anijet që prekin portet dhe radat e Republikës së Shqipërisë e që kryejnë veprime tregtare.
2. Taksa vjetore e qarkullimit rrugor të mjeteve caktohet sipas shtojcës nr.1, që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij. Kjo taksë caktohet në bazë të llojit të mjetit të transportit rrugor. Niveli i taksës shprehet në një kuotë të caktuar, sipas llojit të mjetit. Detyrimi për taksën i takon pronarit të mjetit. Kjo taksë arkëtohet në çastin e kryerjes së kontrollit të parë teknik të mjeteve.

E ardhura nga taksa, për çdo rast, mbledhet nga strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, drejtoritë rajonale, para kryerjes së kontrollit teknik vjetor të mjetit. Për mjetet, që regjistrohen për herë të parë, taksa paguhet e plotë, pavarësisht nga data e regjistrimit dhe është e vlefshme për 365 ditë.

Kjo taksë hyn në fuqi më 1.1.2009.

3. Taksa e mjedisit caktohet si më poshtë:

- 3.1. Taksa e importimit të mjeteve të përdorura caktohet:

- 3.1.1. Për mjetet me 10 ose më shumë vite përdorimi:

- a) për mjetet e transportit me motor, sipas përcaktimeve të kreut 8702 të Nomenklaturës së

Kombinuar të Mallrave, për transportin e jo më shumë se 20 personave, përfshirë shoferin dhe për mjete të tjera, për transportin e mallrave, sipas përcaktimeve të kreut 8704 të NK-së, me peshëmbajtje deri në 5 tonë, 128 000 lekë;

b) për mjetet e transportit me motor, sipas përcaktimeve të kreut 8702 të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave, për transportin e jo më shumë se 20 personave, përfshirë shoferin dhe për mjete të tjera për transportin e mallrave, sipas përcaktimeve të kreut 8704 të NK-së, me peshëmbajtje mbi 5 tonë, 160 000 lekë;

c) për traktorët rrugorë, që klasifikohen në kreun 8701 të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave, 40 000 lekë.

3.1.2. Për mjetet me më pak se 10 vite përdorimi:

a) për mjetet e transportit me motor, sipas përcaktimeve të kreut 8702 të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave, për transportin e jo më shumë se 20 personave, përfshirë shoferin dhe për mjete të tjera për transportin e mallrave, sipas përcaktimeve të kreut 8704 të NK-së, me peshëmbajtje deri në 5 tonë, 80 000 lekë;

b) për mjetet e transportit me motor, sipas përcaktimeve të kreut 8702 të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave, për transportin e jo më shumë se 20 personave, përfshirë shoferin dhe për mjete të tjera, për transportin e mallrave, sipas përcaktimeve të kreut 8704 të NK-së, me peshëmbajtje mbi 5 tonë, 100 000 lekë;

c) për traktorët rrugorë, sipas përcaktimeve të kreut 8701 të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave, 48 000 lekë.

3.1.3. Taksa e importimit të autovecurave dhe të mjeteve të tjera, sipas përcaktimeve të kreut 8703 të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave, llogaritet sipas formulës së mëposhtme:

Taksa fikse x cilindrata e motorit x koeficienti i viteve të përdorimit;

- “Taksa fikse” për çdo autovecurë dhe mjet tjetër, sipas kreut 8703 të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave, me benzinë, caktohet 20 000 lekë dhe për çdo autovecurë dhe mjet tjetër, sipas kreut 8703 të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave, me naftë, 25 000 lekë;

- “Cilindrata e motorit” është vëllimi i dhomës së djegies së motorit, i shprehur në centimetër kub (cm³);

- “Koeficientët e viteve të përdorimit” janë si më poshtë:

- | | |
|-------------------------------------|---------|
| i) deri në 2 vite përdorimi | 0,0016; |
| ii) mbi 2 deri në 4 vite përdorimi | 0,0024; |
| iii) mbi 4 deri në 7 vite përdorimi | 0,0029; |
| iv) mbi 7 deri në 10 vite përdorimi | 0,0032; |
| v) mbi 10 vite përdorimi | 0,0048. |

Taksa nuk duhet të jetë më pak se 60 000 lekë për autovecurat dhe mjetet e tjera, sipas përcaktimeve të kreut 8703 të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave, për 10 ose më shumë vite përdorimi dhe jo më pak se 40 000 lekë, për më pak se 10 vite përdorimi.

- “Vite përdorimi” është diferenca ndërmjet vitit kur mjeti hyn në qarkullim të lirë në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, me vitin e prodhimit.

3.2. Taksa e karbonit caktohet në masën 0,5 lekë për litër, për benzinën dhe benzolin dhe 1 lekë për litër, për gazoilin. Kjo taksë zbatohet si për karburantet e importuara, edhe për ato të prodhuara në vend.

3.3. Taksa për ambalazhin plastik të lëngjeve, sipas shkronjës “c” të pikës 3 të nenit 3 të këtij ligji caktohet në masën:

- 2 lekë për copë, për ambalazhet me kapacitet mbi 1,5 litra;
- 1 lekë për copë, për ambalazhet me kapacitet 1,5 litra ose më pak se 1,5 litra.

4. Taksa e rentës minerare caktohet sipas shtojcës nr.2, që i bashkëlidhet ligjit dhe është pjesë përbërëse e tij. Çdo person fizik apo juridik, që është i licencuar dhe vepron në industrinë minerare, sipas një marrëdhënieje kontraktuale me ministrin përgjegjës për ekonominë, duhet të paguajë rentë minerare për burimet natyrore që nxjerr nga/mbi/dhe nëntoka e territorit të Republikës së Shqipërisë, sepse personi fizik apo juridik nxjerr dhe transferon produktin për qëllime fitimprurëse. Renta minerare llogaritet si detyrim mujor i subjektit taksapagues, në çastin kur ai shet produkte minerare.

Në rastin e eksportit të produkteve minerare, renta paguhet në çastin e bërjes së deklaratës së eksportit.

Renta minerare përcaktohet duke shumëzuar vlerën totale të shitjes me shumicë të produktit me përqindjen e rentës, sipas përcaktimeve të shtojcës nr.2, që i bashkëlidhet këtij ligji. Pagesa e rentës minerare bëhet brenda datës 15 të muajit pasardhës, kur janë realizuar shitjet. Degët e doganave në rrethe ngarkohen për vjeljen e kësaj rente, në rastin e eksportit të produkteve minerare, ndërsa degët e tatimeve ngarkohen për vjeljen e kësaj rente, në rastin e shitjes së produkteve minerare brenda vendit.

Vlera në përqindje e rentës minerare, e përcaktuar në nenet 51, 74 e 83 të ligjit nr.7796, datë 17.2.1994 “Ligji mineral i Shqipërisë”, të ndryshuar, ndryshon sipas paragrafëve të parë e të dytë të pikës 4 të nenit 4 të këtij ligji. Përcaktimi i vlerës së rentës së pasurisë minerare, për të gjitha mineralet, sipas përcaktimeve të ligjit nr.7796, datë 17.2.1994 “Ligji mineral i Shqipërisë”, të ndryshuar, kryhet në përputhje me përcaktimet e bëra në shtojcën nr.2, që i bashkëlidhet këtij ligji.

Këshilli i Ministrave, në bazë të kësaj shtojce, përcakton vlerën e saktë, në përqindje, të rentës së pasurisë minerare, sipas vlerës së tregut, për çdo mineral apo grup mineralesh.

5. Taksa e akteve dhe e pullës caktohet sipas lidhjes nr.3, e cila i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

6. Taksa për regjistrimin e lojërave të fatit, kazinotë, konkurset për parashikimet sportive, për lotarinë kombëtare, për garat sportive, që zhvillohen në hipodrom, caktohet si më poshtë për:

- | | |
|--|---------------------|
| - lojërat e fatit, si lojëra aritmetike, | |
| lojëra fati sportive dhe elektronike, | |
| me fitim në çast | 10 000 000 lekë; |
| - kazinotë | 1 000 000 000 lekë; |
| - lotarinë kombëtare | 120 000 000 lekë; |
| - garat sportive që zhvillohen në Hipodrom | 20 000 000 lekë; |
| - konkurset për parashikimet sportive | 120 000 000 lekë. |

7. Taksa e ushtrimit të veprimtarisë së peshkimit caktohet sipas shtojcës nr.4, që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 5

Agjentët e taksave

Sipas llojit të taksave kombëtare, agjentët që ngarkohen me vjeljen e tyre janë:

a) për taksat portuale, kapiteneria e porteve, e cila i vjel këto taksa drejtpërdrejt ose nëpërmjet agjencive detare, shtetërore apo private;

b) për taksën vjetore të qarkullimit rrugor të mjeteve, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor;

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit në Ministrinë e Brendshme, nëpërmjet degëve në rrethe, kontrollon pagimin e taksës nga zotëruesit e mjeteve dhe, kur vëren se nuk është paguar, zbaton gjobë, të barabartë me masën e taksës. Kur taksa apo gjoba nuk paguhet brenda 10 ditëve, ajo bllokton mjetin deri në pagesën e tyre. Për mjetet që regjistrohen për herë të parë, taksa paguhet e plotë, pavarësisht nga data e regjistrimit dhe është e vlefshme për 365 ditë;

c) për taksën e mjedisit, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, nëpërmjet degëve të doganave në rrethe, për importimin e makinave të përdorura, për karburantin e importuar dhe për ambalazhet plastike të lëngjeve të importuara, si dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, nëpërmjet degëve të saj, për karburantin e prodhuar në vend dhe për ambalazhet plastike të lëngjeve, të prodhuara në vend;

ç) për taksën e rentës minerare, organet doganore e tatimore;

d) për taksën e akteve dhe të pullës, zyrat e gjendjes civile;

dh) për taksat për regjistrimin e lojërave të fatit, si lojëra aritmetike, lojëra fati sportive, lojëra elektronike, me fitim në çast, për lotarinë kombëtare, për kazinotë dhe për garat sportive që zhvillohen në hipodrom, struktura përgjegjëse e lojërave të fatit në ministrinë përgjegjëse për ekonominë;

e) për taksën e ushtrimit të veprimtarisë së peshkimit ngarkohet Drejtoria e Politikave të Peshkimit dhe degët e saj në rrethe.

Neni 6

Transferimi i të ardhurave nga taksat kombëtare në Buxhetin e Shtetit dhe në llogaritë e njësive të qeverisjes vendore

Taksa vjetore është e menjëhershme dhe paguhet brenda tremujorit të parë të vitit në vazhdim. Agjentët e taksave janë të detyruar t'i transferojnë taksat e vjela në Buxhetin e Shtetit dhe në llogari të bashkive ose të komunave, sipas nenit 5 të këtij ligji, brenda datës 30 të muajit kur janë arkëtuar taksat.

Kur detyrimi për pagimin e taksave vjetore për herë të parë lind në 6-mujorin e parë, paguhet 100 për qind e taksës, ndërsa kur ky detyrim lind në 6-mujorin e dytë, paguhet 50 për qind e masës së këtyre taksave.

Neni 7

Taksat që vilen nëpërmjet pullës

Taksat kombëtare, që vilen nëpërmjet pullës, janë taksa vjetore e qarkullimit rrugor të mjeteve dhe taksa e akteve të gjendjes civile.

Neni 8

Komisionet që përfitojnë agjentët e taksave

1. Taksat arkëtohen nga agjentët e taksave, të përcaktuar në nenin 5 të këtij ligji dhe transferohen, sipas tarifave të përcaktuara në nenin 4 të këtij ligji, në llogaritë e të ardhurave tatimore të Buxhetit të Shtetit dhe të buxhetit të njësive të qeverisjes vendore, sipas nenit 5 të këtij ligji.

2. Agjentëve të taksave, për shërbimin që kryejnë, u jepet komisioni përkatës, në rrugë buxhetore. Ky komision llogaritet në përqindje në bazë të masës së taksave që kanë arkëtuar dhe kanë transferuar në Buxhetin e Shtetit dhe në buxhetin e njësive të qeverisjes vendore. Masa në përqindje e komisionit është si më poshtë:

- | | |
|---|-------------|
| a) për taksat portuale (kapitenerisë së porteve) | 2 për qind; |
| b) për taksën vjetore të qarkullimit rrugor të mjeteve nga të cilat: | 8 për qind; |
| - Drejtorisë së Përgjithshme të Transportit Rrugor | 6 për qind; |
| - Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit në Ministrinë e Brendshme | 2 për qind. |
| c) për taksën e mjedisit | 0 për qind; |
| ç) për taksën e akteve dhe të pullës | 5 për qind; |
| d) për taksën e rentës minerare (Royalty) | 0 për qind; |
| dh) për taksën e regjistrimit të lojërave të fatit, si lojëra aritmetike, lojëra fati sportive, lojëra elektronike, me fitim në çast, për lotarinë kombëtare, për kazinotë dhe për garat sportive që zhvillohen në hipodrom | 0 për qind. |

3. Komisionet e përfituara përdoren:

- a) në formën e shpërblimit mbi pagën, për vështirësi në punë, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi;
- b) në formën e pagës, për rastet kur merren punonjës të rinj, për përballimin e vjeljes së taksave;
- c) për mekanizimin, informatizimin, përmirësimin e kushteve të punës, si dhe për përballimin e shpenzimeve për vjeljen e taksave.

Neni 9

Përrjashtimet nga pagimi i taksave kombëtare

1. Përrjashtohen nga pagimi i taksës vjetore të qarkullimit rrugor të mjeteve:

- a) mjetet në pronësi të ambasadave dhe organizatave ndërkombëtare, që gëzojnë status diplomatik, të akredituara në Republikën e Shqipërisë, duke zbatuar parimin e reciprocitetit;

b) personat fizikë ose juridikë, të cilët deklarojnë, brenda muajit janar të vitit në vazhdim, se nuk do të qarkullojnë me mjetet në pronësi të tyre gjatë këtij viti kalendarik dhe dorëzojnë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor targën dhe lejen e qarkullimit të mjetit;

c) invalidët tetraplegjikë, që e fitojnë këtë status, në bazë të ligjeve përkatëse, kur mjeti është në zotërimin e tyre dhe përdoret vetëm për nevojat e tyre vetjake dhe jo për veprimtari private.

Sipas nenit 16/1 të ligjit nr.7889 datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidit” dhe të nenit 4 të ligjit nr.8098, datë 28.3.1996 “Për statusin e të verbrit”, kur invalidi i punës dhe personi i verbër ushtrojnë veprimtari private, nuk përjashtohen nga pagimi i kësaj takse.

2. Përjashtohen nga pagimi i taksës së mjedisit, për komponentin e taksës së importimit të mjeteve të përdorura, invalidët dhe veteranët e luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar, invalidët e punës, të verbrit, invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë, që e fitojnë këtë status, në bazë të ligjeve përkatëse, kur mjeti importohet për zotërimin e tyre dhe përdoret vetëm për nevojat e tyre vetjake dhe jo për veprimtari private.

3. Përjashtohen nga pagimi i taksës së akteve dhe të pullës:

a) veprimet zyrtare, që kërkohen nga autoritetet e huaja, në bazë reciprociteti;

b) regjistrimi i lindjeve dhe i vdekjeve, si dhe shënimet në regjistrat e gjendjes civile.

Neni 10

Shkeljet dhe sanksionet

1. Shkeljet e dispozitave të këtij ligji, që përbëjnë kundërvajtje administrative, përcaktohen sipas ligjit për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë dhe, kur nuk përbëjnë vepër penale, dënohen po sipas ligjit të procedurave tatimore në Republikën e Shqipërisë.

2. Procedurat e ankimit dhe të ekzekutimit të masave administrative bëhen në përputhje me ligjin për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë.

Neni 11

Tarifa shërbimi

1. Përveç tarifave të shërbimit, të përcaktuara në aktet e tjera ligjore dhe nënligjore, quhen tarifa shërbimi edhe:

a) tarifa e pajisjes me leje drejtimi e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor;

b) tarifa për përdorimin e aparateve televizive e Radiotelevizionit Publik Shqiptar;

c) tarifa konsullore e Ministrisë së Punëve të Jashtme apo e ambasadave tona jashtë vendit dhe tarifa për lëshimin e pasaportave të udhëtimit e Ministrisë së Brendshme;

ç) tarifa për veprime e shërbime të administratës gjyqësore e Ministrisë së Drejtësisë, prokurorisë, noterisë dhe zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme;

d) tarifa për shërbimet e transmetimeve radiotelevizive e Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit (KKRT);

dh) tarifa për pajisjen me pasaportë lundrimi e kapitenerisë së porteve;

e) tarifa për shërbimet e radiokomunikimit e Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP);

ë) tarifa për qarkullimin e automjeteve të huaja e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave;

f) tarifa për kalimin me avion të kufirit të Republikës së Shqipërisë.

2. Nivelet minimale të tarifave të shërbimit, të përmendura në pikën 1 të këtij neni, përcaktohen me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Financave dhe institucioneve përkatëse.

Neni 12

Shfuqizimet

Ligji nr.8977, datë 12.12.2002 “Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, shfuqizohet.

Neni 13

Ngarkohet Ministria e Financave të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji.

Neni 14

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.5862, datë 1.8.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë
Bamir Topi**

SHTOJCA NR.1

MASA E TAKSËS VJETORE TË QARKULLIMIT RRUGOR TË PËRVITSHËM TË MJETEVE

Nr.	Tipi i Mjetit	Masa e taksës në lekë
1	Ciklomotorë	0
2	Motomjete	500
3	Autoveturë: <= 4+1 vende, benzinë <= 4+1 vende, naftë > 4+1 deri me 8+1 vende, benzinë > 4+1 deri me 8+1 vende, naftë	7 000 10 000 25 000 35 000
4	Automjet transport i përzier: <= 3 tonë > 3 tonë deri 3.5 tonë	26 000 37 000
5	Kamionë: Mbi 3.5 tonë – 7.5 tonë Mbi 7.5 tonë – 18 tonë Mbi 18 tonë	46 000 64 000 92 000
6	Autobus: Nga 8+1 deri 32+1 vende Mbi 32+1 deri 42+1 vende Mbi 42+1 vende dhe artikulare	34 000 43 000 53 000
7	Automjet për përdorim të veçantë: Deri 3.5 tonë Mbi 3.5 tonë deri 7.5 tonë, Mbi 7.5 tonë deri 18 tonë Mbi 18 tonë	37 000 46 000 64 000 92 000
8	Automjet për transport të veçantë: <= 3.5 tonë Mbi 3.5 tonë deri 7.5 tonë Mbi 7.5 tonë deri 18 tonë Mbi 18 tonë	37 000 46 000 66 000 106 000
9	Tërheqës rrugor	50 000
10	Autokamp	46 000
11	Rimorkio: Deri 750 kg (karrel) shtojcë Mbi 750 kg deri në 1500 kg Mbi 1500 kg deri 7000 kg Mbi 7000 kg	5 000 8 000 10 000 17 000
12	Gjysmë rimorkio: <= 7000 kg dhe > 7000 kg	36 000
13	Makina bujqësore: Deri 3.5 tonë Mbi 3.5 tonë deri 7.5 tonë	2 000 2 000

	Mbi 7.5 tonë deri 18 tonë	2 000
	Mbi 18 tonë	2 000
14	Makina teknologjike: Deri 3.5 tonë Mbi 3.5 tonë deri 7.5 tonë Mbi 7.5 tonë deri 18 tonë Mbi 18 tonë	20 000 38 000 48 000 54 000
15	Mjete rrugore të veçanta: Deri 3.5 tonë Mbi 3.5 tonë deri 7.5 tonë Mbi 7.5 tonë deri 18 tonë Mbi 18 tonë	37 000 46 000 64 000 92 000

SHTOJCA NR.2
PËRQINDJA E RENTËS MINERARE SIPAS KLASIFIKIMIT

GRUPET	PËRSHKRIMI	MASA E TAKSËS
1	Grupi parë (I) Mineralet metalike	
	Mineralet e argjendit	10%
	Mineralet e arit	10 %
	Mineralet e bakrit	4-7 %
	Mineralet e plumbit	4-7 %
	Mineralet e zinkut	4-7 %
	Mineralet e hekurit (hekur-nikelit)	4-5 %
	Mineralet e nikelit (nikelit silikat)	4-6 %
	Mineralet e kromit	4-8 %
	Mineralet e tjera metalike	4 %
2	Grupi i dytë (II) Mineralet jometalike	Masa e taksës
	Mineralet jometalike	3-5 %
3	Grupi i tretë (III) Qymyret dhe bitumet	Masa e taksës
	Bitumet	4-7 %
	Pirobitumet	4-7 %
	Rërat bituminoze	4-6 %
	Reshpet naftore	4-6 %
	Qymyret	4-5 %
4	Grupi i katërt (IV) Mineralet dhe materialet e ndërtimit	Masa e taksës
	Pllakat e ndërtimit	10 %
	Pllagjiogranitet	4-6 %
	Ranoret	4-10 %
	Konglomeratet	4-10 %
	Traktolitet	4-6 %
	Bazaltet	4 %
	Gabrot	4-6 %
	Mermeri	4-10 %
	Graniti	4-6 %
	Travertinat	4-6 %
	Serpentinitet	4-6 %
	Gëlqeroret	4 %
	Mineralet e tjera të grupit të katërt	4 %
5	Grupi i pestë (V) Gurët e çmuar	Masa e takës

	Gurët e çmuar	10 %
6	Grupi i gjashtë (VI) Gurët gjysmë të çmuar dhe opali	
	Gurët gjysmë të çmuar dhe opali	10 %
7	Grupi i shtatë (VII)	
	Nafta dhe gazi	10 %

SHTOJCA NR.3
TAKSA E AKTEVE DHE E PULLËS

	Masa e Taksës Në lekë
1. Për lëshimin e certifikatave të gjendjes civile	50
2. Për lëshimin e kartave të identitetit për brenda vendit	100
3. Për marrjen e çdo akti të emetuar ose të zhdukur të gjendjes civile, si dhe për korrigjimet e tyre	50
4. Për regjistrimin e dhënies së shtetësisë	700
5. Për regjistrimin e lënies së shtetësisë	700
6. Për regjistrimin e vendimit të ndërrimit të emrit ose mbiemrit	700
7. Për çdo lidhje martese	600

SHTOJCA NR.4
TAKSA VJETORE PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SË PESHKIMIT

	Lekë në vit
I. Peshkimi detar (për 1 anije)	
1. Peshkimi detar fundor:	
- anije 160-200 HP	40 000
- anije 201-410 HP	50 000
- anije mbi 410 HP	80 000
2. Peshkimi pellagjik me tratavolante:	
- anije 160-200 HP	20 000
- anije 201-410 HP	30 000
- anije mbi 410 HP	40 000
3. Peshkimi pellagjik me rrethime:	
- anije 80-200 HP	10 000
- anije 201-410 HP	20 000
- anije mbi 410 HP	30 000
4. Peshkimi pellagjik dhe fundor:	
- anije 160-200 HP	40 000
- anije 201-410 HP	60 000
- anije mbi 410 HP	90 000
5. Peshkimi me mjete selektike:	
- anije 40 - 80 HP	15 000
- anije 81-160 HP	25 000
- anije 161-200 HP	40 000
- anije 201-410 HP	50 000
- anije mbi 410 HP	80 000
6. Peshkimi i molusqeve bivalvore (i autorizuar)	60 000
II. Peshkimi artizanal me mjete të lehta:	
1. Peshkimi në bregdet (për një sanall dhe me motor deri në 40HP)	7 000

2. Peshkimi në lagunat bregdetare:	
- në lagunë (1 lundror)	10 000
- në dajlane (1 peshkatar)	12 000
3. Peshkimi në ujëra të brendshme:	
- aktiv (1 lundror)	5 000
- në dajlane e prita (1 peshkatar)	8 000
4. Grumbullimi i molusqeve bivalvore me mjete të lehta (gabie) për 1(një) peshkatar	20 000

III. Peshkimi sportiv në det

me mjete lundruese (për 1 mjet)	40 000
---------------------------------	--------

IV. Akuakultura:

1. Kultivimi i midhjeve për një impiant	10 000
2. Kultivimi i peshqve me impiante në det, në liqene, në rezervuarë	1 000
3. Akuakulturë me impiante në tokë	10 000

Shënim: Për anijet e huaja që marrin licencë peshkimi në ujërat tona territoriale, taksa e lejes së ushtrimit të veprimtarisë është sa dyfishi i anijeve shqiptare. Nuk i nënshtrohen kësaj takse anijet e autorizuar nga Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave (Drejtoria e Politikave të Peshkimit), që do të peshkojnë për qëllime studimore e shkencore.

DEKRET

Nr.5815, datë 25.7.2008

PËR EMËRIMIN E SHEFIT TË SHTABIT TË PËRGJITHSHËM TË FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 169, pika 3 të Kushtetutës, të nenit 7, pika 5, si dhe të nenit 30, pika 1 të ligjit nr.8671, datë 26.10.2000 “Për pushtetet dhe autoritetet e komandimit e të drejtimit strategjik të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, me propozim të Kryeministrit,

DEKRETOJ:

Neni 1

Gjeneral Brigade Maksim Malaj, emërohet Shef i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Bamir Topi

DEKRET

Nr.5817, datë, 25.7.2008

PËR LEJIM LËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” të Kushtetutës, të neneve 15, 19 dhe 20 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Brendshëm

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohej lënia e shtetësisë shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Silvana Shaban Mastori (Vrana)
2. Julio Sokol Mastori
3. Akile Miço Gramatiko
4. Angjelina Jorgji Gramatiko (Nika)
5. Klajd Akile Gramatiko
6. Juna Lutfi Zhegu
7. Alba Lulzim Koni
8. Andiola Ylli Xhabafti
9. Rozeta Fuat Abazi
10. Elton Jorgji Veveçka
11. Marjeta Ismet Bakllava (Dautaj)
12. Beke Besnik Haberbosch (Balila)
13. Sonila Thanas Misho
14. Qamil Sherif Weber (Halilaj)
15. Eduart Syrja Ahmetaj
16. Albana Ismail Brari (Gërdeci)
17. Leonard Tefik Gjolla
18. Ardian Nazif Nazifi
19. Olsi Pëllump Selimollari
20. Rovenà Anesti Xhexhi
21. Petrit Zeni Xheli
22. Enrico Petrit Xheli
23. Fatbardha Gani Xheli (Xhaferri)
24. Ariola Petrit Xheli
25. Ermir Ismail Qeli
26. Edmond Nikolla Rista
27. Bashkim Nexhmedin Nenaj
28. Hatixhe Hajri Nenaj (Xhaferaj)
29. Melina Pano Rosenberger (Lula)
30. Johana Bardhyl Demaj
31. Valbona Jonuz Beka (Fikaj)
32. Florim Lulzim Beka
33. Adriana Bedri Muçaj (Bushati)
34. Saflela Mema
35. Xhoana Fejzi Lang (Bozgo)
36. Behar Veli Domi
37. Engjëllushe Emin Çizmja (Keçi)
38. Alban Pal Ndoj
39. Frosina Spiro Shebeku (Vidheshtari)
40. Onida Anton Bytyçi
41. Virxhina Durim Bajrami
42. Etleva Haxhi Rode (Kacmali)
43. Dallëndyshe Çuman Wrage (Bilali)
44. Erjon Sitki Zymyli
45. Julinda Ahmet Gllavata
46. Eglantina Mustafa Kuniß (Isufi)
47. Gert Fredi Mariani
48. Rrahman Abdi Kurti
49. Shkëlzen Ferko Dokaj

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bamir Topi

DEKRET
Nr.5845, datë 29.7.2008

PËR EMËRIMIN E REKTORIT TË UNIVERSITETIT “ALEKSANDËR MOISIU”, DURRËS

Në mbështetje të nenit 92, pika “g” të Kushtetutës, si dhe të nenit 21, pika 8 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zoti Agim Shefki Kukeli, emërohet Rektor i Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bamir Topi

VENDIM
Nr.1045, datë 16.7.2008

**PËR TRAJTIMIN E KREDIVE TË TRANSFERUARA NGA BANKAT E NIVELIT TË DYTË,
ME KAPITAL TËRËSISHT SHTETËROR, NË AGJENCINË E TRAJTIMIT TË KREDIVE,
KRITERET DHE KUSHTET PËR NDRYSHIMIN E MARRËVESHJES SË KREDISË, SI
DHE PROCEDURAT E MARRJES NË PRONËSI TË PASURIVE TË LËNA SI GARANCI
OSE JO NGA HUAMARRËSIT, TË ADMINISTRIMIT, SHITJES DHE DHËNIES ME QIRA
OSE ME ENFITEOZË TË KËTYRE PASURIVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 18 të ligjit nr.9731, datë 10.5.2007 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8894, datë 14.5.2002 “Për Agjencinë e Trajtimit të Kredive”, të ndryshuar me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

KREU I

TRAJTIMI I KREDIVE TË TRANSFERUARA NGA BANKAT E NIVELIT TË DYTË

1. Agjencia e Trajtimit të Kredive, me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, nëpërmjet ndryshimit të marrëveshjes së kredisë me debitorin, ka të drejtë të ristrukturojë njërën prej kushteve të mëposhtme, të parashikuara në marrëveshjen e kredisë së transferuar asaj me debitorin:

a) Faljen e interesave, të kamatëvonesave dhe të gjobave debitorëve, që, në datën e transferimit të kredisë nga bankat, të cilat shumën e principalit e kanë pasur deri në 3 (tre) milionë lekë, duke u kërkuar të likuidojnë menjëherë vetëm principalin e transferuar nga bankat apo shumën e mbetur të principalit. Për kreditë të transferuara në valutë, konvertimi bëhet me kursin fiks të Bankës së Shqipërisë, në çastin e transferimit;

b) Faljen e interesave, të kamatëvonesave dhe gjobave, të gjithë debitorëve, që kanë marrë kredi për mekanikë bujqësore (autokombajna, traktorë, makineri e agregate bujqësore), prodhim dhe përpunim të produkteve bujqësore e blegtorale, linjë prodhimi dhe përpunimi të produkteve, bujqësore dhe blegtorale dhe mjete të transportit, pavarësisht nga shuma e principalit të transferuar nga bankat, duke u kërkuar të likuidojnë menjëherë vetëm principalin e transferuar apo pjesën e mbetur prej tij;

c) Faljen, në masën 90 për qind, të interesave, kamatëvonesave, gjobave, të gjithë debitorëve, që, në datën e transferimit të kredisë nga bankat, shumën e principalit e kanë pasur mbi 3 (tre) milionë lekë, duke u kërkuar të likuidojnë menjëherë të paktën 40 për qind të principalit të transferuar apo të shumës së mbetur prej tij, si dhe duke vendosur kushtet për shlyerjen e pjesës tjetër. Periudha e pagesës së shumës së mbetur të kredisë nuk mund të jetë më e gjatë se 3 (tre) vjet. Për kreditë e dhëna në valutë, konvertimi bëhet me kursin fiks të Bankës së Shqipërisë, në çastin e transferimit. Llogaritja e detyrimit të ri, nëse do të mbetet, do të bëhet duke zbatuar normën e interesit 10 për qind, për kreditë në lekë, dhe 5 për qind, për kreditë në valutë;

ç) Debitorëve, që kanë marrë kredi për banesa ose për përmirësimin e kushteve të banimit, me vendndodhje në rrethet e kategorisë së dytë dhe të tretë, interesat, kamatëvonesat dhe gjobat u falen në masën 100 për qind, dhe huamarrësve, me vendndodhje në rrethet e kategorisë së parë, u falen, në masën 80 për qind. Falja bëhet me kusht që të shlyhet menjëherë, të paktën 40 për qind e principalit të transferuar apo e shumës së mbetur prej tij, si dhe duke vendosur kushtet për shlyerjen e pjesës tjetër. Periudha e pagesës së shumës së mbetur të kredisë nuk mund të zgjatet më shumë se 3 vjet. Llogaritja e detyrimit të ri, nëse do të mbetet, do të bëhet duke zbatuar normën e interesit 10 për qind në vit, me përjashtim të kredive, që, në marrëveshjen ekzistuese të huasë, normën e interesit e kanë më të ulët;

d) Për debitorët, që kanë vdekur, u kërkohej trashëgimtarëve të tyre të likuidojnë vetëm shumën e principalit të mbetur. Periudha e pagesës së shumës së mbetur të kredisë nuk mund të zgjatet më shumë se 3 vjet, në varësi të llojit të kredisë, që trashëgohet;

dh) Faljen e të gjitha detyrimeve të transferuara nga bankat, të përbëra vetëm nga interesa, penalitete dhe/apo kamatëvonesa.

2. Në funksion të përllogaritjeve të parashikuara në pikën 1 të këtij kreu :

a) për të gjithë debitorët, me shumën e principalit të transferuar nga bankat deri në 3 (tre) milionë lekë, të gjitha pagesat e kryera nga çasti i transferimit përllogariten si shuma të paguara për shlyerjen e principalit dhe do të zbriten nga shuma e principalit të transferuar;

b) për të gjithë debitorët, me shumën e principalit të transferuar nga bankat mbi 3 (tre) milionë lekë, të gjitha pagesat e kryera nga çasti i transferimit do të zbriten nga shuma e principalit të transferuar;

c) për debitorët, të cilëve u kanë përfunduar procedurat e shitjes së kolateralit dhe janë sërish debitorë të Agjencisë së Trajtimit të Kredive, kërkohej likuidimi i vetëm 50 për qind e detyrimit të mbetur;

ç) debitorët, që kanë lidhur kontrata ristrukturimi, në bazë të akteve, ligjore e nënligjore në fuqi, para datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi, gëzojnë të drejtën e trajtimit, sipas këtij vendimi;

d) kur në marrëveshjen ekzistuese të kredisë janë përcaktuar norma interesi më të ulëta se ato të përcaktuara në shkronjat “c” e “ç” të pikës 1 të kreut të këtij vendimi, do të zbatohen normat e interesave, të përcaktuara në marrëveshjen ekzistuese.

3. Detyrimet e transferuara nga bankat, të përbëra nga shpenzime gjyqësore dhe/apo përmbarimore nuk falen.

PROCEDURAT E MARRJES NË PRONËSI TË PASURIVE TË LËNA SI GARANCI OSE JO NGA
HUAMARRËSIT, TË ADMINISTRIMIT, SHITJES E DHËNIES ME QIRA OSE ME ENFITEOZË
TË KËTYRE PASURIVE

1. Këtij vendimi i nënshtrohen të gjitha pasuritë e lëna si garanci ose jo nga debitorët e Agjencisë së Trajtimit të Kredive, të cilat kalojnë në pronësi të saj, si pronë shtetërore, pasi nuk janë shitur në ankandet e zhvilluara nga përmbaruesi gjyqësor, në zbatim të procedurave ligjore për ekzekutim të detyrueshëm.

2. Marrja në pronësi e pasurive të lëna nga debitorët, sipas pikës 1 të këtij kreu, bëhet me pëlqimin e Agjencisë së Trajtimit të Kredive, si palë kreditore, kundrejt vlerës së ankandit të fundit, të zhvilluar nga përmbaruesi gjyqësor. ATK-ja e kontabilizon pronën me vlerën e parashikuar nga përmbaruesi gjyqësor në aktin e transferimit.

3. Pas kontabilizimit të pronës ATK-ja, kundrejt shlyerjes së detyrimit, i propozon debitorit kthimin e sendit të marrë në pronësi. Debitori duhet të kthejë përgjigje brenda 30 ditëve nga data e njoftimit.

4. Pas kalimit të këtij afati, Agjencia e Trajtimit të Kredive përgatit dosjen për shitjen me ankand. Procedurat e ankandit organizohen nga Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronës Shtetërore, pranë Ministrisë së Financave. Si vlerë e pronës, që do të shitet me ankand, do të llogaritet vlera e kontabilizuar nga Agjencia e Trajtimit të Kredive.

5. Ndarja e të ardhurave nga shitja e këtyre pronave, pavarësisht nga lloji, bëhet, si më poshtë vijon:

i) Agjencia e Trajtimit të Kredive 25 për qind;

ii) Buxheti i Shtetit 75 për qind.

6. Shuma e përgjithshme, e realizuar nga shitja me ankand e pronës, vlerësohet nga ATK-ja, për efekt të deklarimit të realizimit të të ardhurave.

7. Pronat e kaluara në pronësi të ATK-së, me miratimin e Ministrit të Financave, mund t'i transferohen shtetit dhe t'u kalojnë në përgjegjësi administrimi institucioneve shtetërore. Në këtë rast, vlera e pronës, e parashikuar në pikën 2, të këtij kreu, vlerësohet nga ATK-ja, për efekt të deklarimit të realizimit të të ardhurave dhe kontabilizohet, duke zbritur detyrimin e debitorit.

KREU III

KRITERET E KUSHTET, QË DUHEN PLOTËSUAR PËR ZËVENDËSIMIN E KOLATERALIT
DHE EKZEKUTIMIN E DETYRUESHËM

1. Debitori ka të drejtë ta kërkojë ristrukturimin e detyrimit, sipas lehtësive të parashikuara në këtë vendim, vetëm një herë. Në rast se debitori nuk u përmbahet kushteve të marrëveshjes së lidhur, kërkohet likuidimi në rrugë ligjore i detyrimit të kontabilizuar në ATK.

2. Zëvendësimi i kolateralit apo debitorit me një pasuri a person tjetër, përveç detyrimeve të parashikuara në Kodin Civil dhe ligjin, që rregullon regjistrimin e pasurive të paluajtshme, realizohet:

a) kur vlera e pasurisë së re, mbi të cilën do të vendoset barra hipotekore, është më e lartë se vlera e pasurisë ekzistuese, të ngarkuar me barrë hipotekore;

b) kur debitori, përpara miratimit për zëvendësimin e kolateralit, arkëton të paktën 20 për qind të detyrimit të transferuar;

c) kur debitori, para fillimit të procedurave për lidhjen e marrëveshjes përkatëse të ristrukturimit, ka likuiduar jo më pak se 40 për qind të detyrimit të transferuar.

3. Çdo debitor, për të cilin ka dalë vendim gjykate, "Për lëshim urdhër ekzekutimi", pavarësisht nëse është dërguar ose jo për ekzekutim të detyrueshëm në zyrën e përmbarimit, i përfiton lehtësitë e këtij vendimi, vetëm nëse ka parapaguar një vlerë jo më të vogël se 7 për qind të detyrimit të përcaktuar në urdhrin e ekzekutimit apo, kur mungon këtu, të detyrimit të llogaritur deri në datën e lëshimit të këtij urdhri. Kur debitori ka vazhduar të shlyejë vlera monetare pas daljes së urdhrin të ekzekutimit, këto vlera zbriten nga detyrimi i ri financiar, që ka huamarrësi, sipas kontratës së ristrukturuar.

KREU IV

DISPOZITA TË FUNDIT

1. Ngarkohet Ministri i Financave të nxjerrë udhëzimin përkatës për zbatimin e këtij vendimi.
 2. Përfitojnë nga lehtësitë e parashikuara në këtë vendim debitorët, të cilët paraqiten deri më 30 prill 2009 në zyrat e Agjencisë së Trajtimit të Kredive, për të nënshkruar kushtet e reja.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM Nr.1046, datë 16.7.2008

PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI, NGA TIPOGRAFIA USHTARAKE SHA, “SHTYPSHKRONJËS SË LETRAVE ME VLERË”, TIRANË, TË DISA REPARTEVE DHE TË NJË TRUALLI FUNKSIONAL

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13, 14 e 15, shkronja “c” të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Tipografia Ushtarake sh.a., “Shtypshkronjës së letrave me vlerë”, Tiranë, të disa reparteve, me sipërfaqe 1 563 (një mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e tre) m², dhe të truallit funksional, me sipërfaqe të përgjithshme 647 (gjashtëqind e dyzet e shtatë) m², sipas planvendosjes, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
 2. Ngarkohen Ministri i Financave, Ministri i Brendshëm dhe zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Tiranë, të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 19, 20 e 21 të ligjit nr.8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe të Ministrit të Punëve të Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.170, datë 25.4.2002 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Kudo në vendim emërtimet “Drejtoria e Përgjithshme e Hidrokarbureve” zëvendësohet me “Struktura përgjegjëse në ministrinë përgjegjëse për hidrokarburet”, dhe “Inspektorati Shtetëror i Kontrollit të Naftës, Gazit dhe Nënprodukteve të tyre” e “Inspektorati i Pajisjeve nën Presion” zëvendësohen me “Inspektorati Qendror Teknik”.

2. Shkronja “d” e pikës 2 të kreut I ndryshohet, si më poshtë vijon:

“d) Leja e shfrytëzimit, e lëshuar nga zyra e urbanistikës.”.

3. Paragrafi i parë i kreut II ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Dhënia e autorizimeve për funksionimin e stacioneve të shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës, për automjetet dhe vajrave lubrifikante bëhet nga:

a) ministri, që mbulon veprimtarinë e transportit rrugor, kur stacioni do të ndërtohet në autostradë, rrugë interurbane kryesore, rrugë interurbane dytësore dhe rrugë vendore, ku ent pronar është Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve;

b) organet e qeverisjes vendore, kur stacioni do të ndërtohet në rrugë urbane kryesore, rrugë urbane dytësore dhe rrugë vendore, ku ent pronar është organi i qeverisjes vendore.

Procedurat për dhënie të drejtës për ndërtimin e stacioneve të shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës, për automjete dhe vajrave lubrifikante, në zonat e shërbimit në rrugët e reja, kombëtare e vendore, kryhen sipas rasteve, nëpërmjet konkurrimit, në bazë të legjislacionit në fuqi.

Këto procedura realizohen nga ministria përgjegjëse për transportin, kur stacionet do të ndërtohen në autostradë, rrugë interurbane kryesore, rrugë interurbane dytësore dhe rrugë vendore, ku ent pronar është Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, dhe nga organet e qeverisjes vendore, kur stacioni do të ndërtohet në rrugë urbane kryesore, rrugë urbane dytësore dhe rrugë vendore, ku ent pronar është organi i qeverisjes vendore.”.

4. Pas shkronjës “dh” të pikës 1 të kreut II shtohet shkronja “e”, më këtë përmbajtje:

“e) Autorizimin për hyrje-dalje në rrugë, të lëshuar nga:

i) Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, kur stacioni do të ndërtohet në autostradë, rrugë interurbane kryesore, rrugë interurbane dytësore dhe rrugë vendore, ku ent pronar është po Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve;

ii) organet e qeverisjes vendore, kur stacioni do të ndërtohet në rrugë urbane kryesore, rrugë urbane dytësore dhe rrugë vendore, ku ent pronar është vetë organi i qeverisjes vendore.”.

5. Pika 2 e kreut IV ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2. Kapaciteti më i vogël i depozitave të shoqërive, që kërkojnë të pajisen me leje tregtimi, sipas llojit të lejes, është:

a) Për lejet e tregtimit të llojit “A”, jo më pak se 3 000 (tre mijë) m³ dhe kur kjo leje jepet për disa kategori produktesh, depozitat, për secilën kategori duhet të jenë të ndara nga njëra-tjetra.

b) Për lejet e tregtimit të llojit “A”, kategoria IV/a, kapaciteti magazinues i mbuluar të jetë, me sipërfaqe jo më të vogël se 100 (një qind) m².

c) Për lejet e tregtimit të llojit “B”, impiantet e depozitimit të gazit të lëngëzuar të jenë me kapacitet të instaluar, jo më pak se 500 (pesë qind) m³.

ç) Për lejet e tregtimit të llojit “C”, kur:

i) leja jepet për produkte të kategorisë II/b, jo më pak se 500 (pesë qind) m³.

ii) leja jepet për produkte të kategorisë III/c, jo më pak se 1 000 (një mijë) m³.

Bëjnë përjashtim nga kushti i plotësimit të kapacitetit më të vogël, sipas kësaj pike, shoqëritë anonime, që kanë marrëdhënie kontraktore, sipas dispozitave ligjore në fuqi, për depozitat e karburanteve në portin e Durrësit. Kushti i kapacitetit më të vogël të depozitave dhe i vendosjes në to

të mjeteve matëse dhe të kalibrimin të tyre duhet të plotësohet, brenda 18 muajve pas fillimit të zbatimit të masterplanit, në territorin e depozitave të karburanteve në portin e Durrësit.

Shoqëritë e pajisura aktualisht me “Leje tregtimi”, brenda pesë vjetëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, duhet të plotësojnë kushtin e kapacitetit minimal, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.”.

6. Pas pikës 6 të kreut IV, shtohet pika 7, me këtë përmbajtje:

“7. Shoqëritë e pajisura me leje tregtimi ose autorizim, brenda 30 ditëve nga data e pajisjes, duhet të kryejnë sigurimin e përgjegjësisë ligjore për dëmet, që mund t’u shkaktohen palëve të treta, për shkak të ushtrimit të veprimtarisë së shoqërisë.

Shoqëritë, që kanë kryer sigurimin e përgjegjësisë ligjore për dëmet, që mund t’u shkaktajnë palëve të treta, sipas përcaktimit të shkronjës “a”, duhet që brenda këtij afati, të paraqesin dokumentin përkatës në organin, që ka lëshuar lejen e tregtimit ose autorizimin. Shoqëria nuk do ta ushtrojë veprimtarinë deri në çastin e paraqitjes së këtij dokumenti në organin, që ka lëshuar lejen e tregtimit ose autorizimin.”.

7. Pas paragrafit të fundit të kreut VI shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

“Në rast të mosrespektimit të shkronjës “b” të pikës 6 të këtij vendimi, organi përkatës për dhënien e lejes së tregtimit apo autorizimit, ka të drejtën e heqjes së kësaj lejeje apo autorizimi për ushtrimin e veprimtarisë.”.

8. Zbatimi i normave të përcaktuara në pikat 3, 4, 5 e 6 fillon gjashtë muaj pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

9. Në rastin e rinovimit të lejeve të tregtimit, kushtet e kapaciteteve minimale të depozitimit do të jenë ato të përcaktuara në pikën 5 të këtij vendimi.

Në rastin e rinovimit të autorizimeve për funksionimin e stacioneve të shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës, për automjete, dhe vajrave lubrifikante, në procedurat për dhënien e këtyre autorizimeve të përfshihen edhe ndryshimet e përcaktuara në pikat 3 e 4 të këtij vendimi.

10. Ngarkohen Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Ministri i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM **Nr.1048, datë 16.7.2008**

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.153, DATË 7.4.2000 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË ZBATIMIT TË KODIT RRUGOR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në rregulloren për zbatimin e Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë, të miratuar me vendimin nr.153, datë 7.4.2000 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

1. Neni 311 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 311

**Mënyrat dhe rrethanat për nxjerrjen e lejes së drejtimit të mjetit
(Nenet 119-120 të Kodit Rrugor)**

1. Leja e drejtimit të mjetit për kategorinë e kërkuar merret pasi personi i interesuar është regjistruar në një autoshtetë dhe:

a) ka kryer pranë saj programin e njohurive teorike, për kategorinë e kërkuar, dhe kalon provën e kontrollit të këtyre njohurive me rezultat pozitiv, pranë sektorit përkatës të DRSHTRR-së;

b) ka kryer programin e ushtrimit të drejtimit të mjetit, për kategorinë e kërkuar, pranë autoshtetës, dhe kalon provën e verifikimit të aftësive drejtuese e të sjelljes, me rezultat pozitiv, pranë sektorit përkatës të DRSHTRR-së.

2. Personi i interesuar për të hyrë në prova për lejedrejtimi të mjetit, në zbatim të nenit 119 të Kodit Rrugor, paraqet, nëpërmjet drejtuesit teknik të autoshtetës, në sektorin përkatës të DRSHTRR-së, dokumentacionin e nevojshëm, që përmban:

I. Për provën e kontrollit të njohurive teorike

a) kërkesën për të marrë pjesë në provë, sipas modelit të hartuar nga DPSHTRR -ja;

b) 4 (katër) fotografi, me ngjyra, me përmasa 4x5 cm;

c) dokumentin e identifikimit (certifikatë lindjeje me fotografi ose kartë identiteti dhe për shtetasit e huaj, pasaportë);

ç) vërtetimin e vendbanimit;

d) certifikatën mjekësore, jo më përpara se tre muaj nga data e paraqitjes së kërkesës, për të marrë pjesë në prova;

dh) dokumentin e përcaktimit të grupit të gjakut dhe rezusin;

e) lejedrejtimit të automjetit të kategorisë së mëparshme (në qoftë se ka);

ë) mandatpagesën, për çdo dalje në provë të kontrollit të njohurive teorike, sipas tarifave në fuqi.

II. Për provën e verifikimit të aftësive drejtuese e të sjelljes

a) kërkesën për të marrë pjesë në këtë provë, sipas modelit të hartuar nga DPSHTRR -ja;

b) autorizimin e ushtrimit të drejtimit të mjetit, përcaktuar sipas udhëzimit të ministrit, që mbulon veprimtarinë përkatëse, të lëshuar nga DRSHTRR -ja dhe të plotësuar nga autoshtetës;

c) mandatpagesën, për çdo dalje, në provën e verifikimit të aftësive drejtuese e të sjelljes;

ç) mandatpagesën për lejedrejtimi, e cila caktohet në bazë të tarifave në fuqi, plus taksën e pajisjes me lejedrejtimi, në varësi të kategorisë së lejedrejtimit.

3. Sektori përkatës i DRSHTRR-së merr në provën e kontrollit të njohurive teorike personat e interesuar në rastet kur:

a) ky person ka kryer programin teorik për kategorinë e kërkuar dhe ka plotësuar afatet kohore nga data e regjistrimit në sektorin përkatës të DRSHTRR-së, sipas udhëzimit të ministrit, që mbulon veprimtarinë përkatëse;

b) dokumentacioni i paraqitur nga autoshtetës për provën e kontrollit të njohurive teorike të personit të interesuar është në përputhje me kërkesat e Kodit Rrugor dhe të rregullores, në zbatim të tij. Kur dokumentacioni nuk është i plotë, i kthehet autoshtetës për të bërë plotësimet, brenda 5 (pesë) ditëve;

c) personi paraqitet brenda orarit të kontrollit të njohurive teorike dhe jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga dorëzimi i kërkesës së autoshtetës. Nëse personi i interesuar fiton në provën e kontrollit të njohurive teorike, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga dalja në provë, sektori përkatës i DRSHTRR-së e pajis atë me autorizimin e ushtrimit të drejtimit të mjetit, për kategorinë e kërkuar, me afat kohor një vit. Nëse personi i interesuar nuk e fiton provën, duhet ta vazhdojë përgatitjen teorike dhe mund të rifutet në provë vetëm pas 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, deri në pesë herë, por brenda afatit njëvjeçar të regjistrimit.

4. Sektori përkatës i DRSHTRR-së do të marrë në provën e verifikimit të aftësive drejtuese e të sjelljes personat e interesuar kur:

a) ky person ka kryer programin e ushtrimit të drejtimit të mjetit, për kategorinë e kërkuar, dhe ka plotësuar afatet kohore nga data e marrjes së autorizimit në sektorin përkatës të DRSHTRR-së, sipas udhëzimit të ministrit, që mbulon veprimtarinë përkatëse;

b) dokumentacioni i paraqitur nga autoshkolla për provën e verifikimit të aftësive drejtuese e të sjelljes së personit të interesuar është në përputhje me kërkesat e Kodit Rrugor dhe të rregullores, në zbatim të tij. Kur dokumentacioni nuk është i plotë, i kthehet autoshkolllës për të bërë plotësimet, brenda 5 (pesë) ditëve;

c) personi paraqitet brenda orarit të provës së verifikimit të aftësive drejtuese e të sjelljes dhe jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e dorëzimit të kërkesës së autoshkolllës. Nëse personi i interesuar fiton në provën e verifikimit të aftësive drejtuese e të sjelljes dhe dokumentacioni është i plotë, jo më vonë se 7 (shtatë) ditë nga dalja në provë, sektori përkatës i DRSHTRR-së e pajis atë me lejedrejtimi, për kategorinë e kërkuar. Nëse personi i interesuar nuk e fiton provën, duhet të vazhdojë përgatitjen e aftësive drejtuese dhe të sjelljes dhe mund të rifutet në provë vetëm pas 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, deri në pesë herë, por brenda afatit njëvjeçar të autorizimit të ushtrimit të drejtimit të mjetit.

5. Komisioni i marrjes në provë për kontrollin e njohurive teorike duhet të ketë dy anëtarë, inxhinierë mekanikë. Gjithashtu, në këtë komision mund të marrë pjesë, pa të drejtë vote, drejtuesi teknik i autoshkolllës, që ka përgatitur personat e interesuar, për provën e kontrollit të njohurive teorike.

6. Komisioni i marrjes në provë të verifikimit të aftësive drejtuese e të sjelljes duhet të ketë, detyrimisht, dy anëtarë inxhinierë mekanikë, të pajisur me të gjitha kategoritë e lejeve të drejtimit dhe të autorizuar nga DPSHTRR-ja. Ky komision merr në provë personin e interesuar, në prani të instruktorit të tij të praktikës.

7. Komisioni i marrjes në provë të kontrollit të njohurive teorike dhe komisioni i marrjes në provë të verifikimit të aftësive drejtuese e të sjelljes kanë për detyrë, respektivisht, të vlerësojnë njohuritë teorike dhe të kontrollojnë njohuritë praktike e të sjelljes së personit të interesuar, sipas programeve të kategorive të lejeve të drejtimit, të përcaktuara nga ministria, që mbulon veprimtarinë përkatëse. Modeli dhe formulari i testeve të njohurive teorike, sipas kategorive të lejeve të drejtimit, përgatiten nga DPSHTRR-ja. Modeli i testeve ndryshohet në vazhdimësi. DPSHTRR-ja duhet të njoftojë autoshkolllat, 30 ditë përpara se të zbatojë modelet e reja për provën e kontrollit të njohurive teorike të personave të interesuar.

8. Në përfundim të provave, për çdo person të interesuar, që fiton lejen e drejtimit, plotësohet dosja përkatëse. Mbi të vendoset emri, mbiemri, atësia, amësia, datëlindja, vendlindja, vendbanimi dhe numri i protokollit. Dosja, me të gjitha dokumentet, ruhet në kartotekën e sektorit përkatës të DRSHTRR-së.”

2. Pikat 3, 7, 8, 10, 11 e 12 të nenit 313, ndryshohen, si më poshtë vijon:

“3. Personi, fizik e juridik, shoqëritë dhe entet, që kërkojnë leje për hapjen e autoshkolllës, duhet të plotësojnë kërkesat e nenit 121 të Kodit Rrugor.

7. Regjistrimi i personave të interesuar për t’u pajisur me lejedrejtimi, bëhet nga vetë autoshkollla. Ajo nuk mund të regjistrojë persona të interesuar për t’u pajisur me lejedrejtimi jashtë juridiksionit të DRSHTRR-së, me përjashtim të studentëve të ardhur apo me qëndrim të përkohshëm, brenda këtij juridiksioni. Përpara fillimit të kursit, gjenealitet e personave të interesuar për t’u pajisur me lejedrejtimi i dërgohen, zyrtarisht, sektorit përkatës të DRSHTRR-së.

8. Përpara çdo prove të njohurive teorike ose të verifikimit të aftësive drejtuese e të sjelljes, autoshkollla dorëzon kërkesën, në dy kopje, në sektorin përkatës të DRSHTRR-së, i cili përditëson kërkesën me dokumentacionin e personit të interesuar për t’u marrë në provë, dhe jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga paraqitja e kërkesës i jep të drejtën për të hyrë në provë, duke dorëzuar një kopje të kërkesës së plotësuar. Komisioni merr në provë personat e interesuar, që kanë kërkesën të plotësuar nga sektori përkatës i DRSHTRR-së. Pas përfundimit të provave, komisioni harton procesverbalin, sipas modelit të miratuar nga DPSHTRR-ja.

10. Automjetet e përgatitjes praktike duhet të plotësojnë kushtet teknike, si më poshtë vijon:

a) për lejedrejtimi të kategorisë “A”, motoçikletë me ose pa kosh, me cilindrata jo më pak se 125 cm³;

b) për lejedrejtimi të kategorisë “B”, automjet i kategorisë “B”, me peshë maksimale deri në 3 500 kg ose automjet, për transport personash, deri në (8+1) vende, e cila duhet të realizojë një shpejtësi, mbi 100 km/orë;

c) për lejedrejtimi të kategorisë “B+E”, automjet i përshtatshëm për provën e kategorisë “B”, e kombinuar me një rimorkio, me peshë maksimale të autorizuar, 1000 kg, bashkimi i të cilave nuk hyn në kategorinë “B”, dhe që duhet të realizojë një shpejtësi mbi 100 km/orë;

ç) për lejedrejtimi të kategorisë “C”, automjet i kategorisë “C”, me peshë maksimale të autorizuar, mbi 12 000 kg, me gjatësi mbi 8 metra, e cila duhet të realizojë një shpejtësi mbi 80 km/orë;

d) për lejedrejtimi të kategorisë “C+E”, automjet i përshtatshëm për provën e kategorisë “C”, e kombinuar me një rimorkio, me gjatësi mbi 7,5 metra, nga kombinimi, me peshë maksimale të autorizuar mbi 20 000 kg, me gjatësi mbi 14 metra, i cili duhet të realizojë një shpejtësi, mbi 80 km/orë;

dh) për lejedrejtimi të kategorisë “D”, automjet i kategorisë “D”, me gjatësi mbi 10 metra, i cili duhet të realizojë një shpejtësi mbi 80 km/orë;

e) për lejedrejtimi të kategorisë “D+E”, automjet i përshtatshëm për provën e kategorisë “D”, e kombinuar me një rimorkio, me peshë maksimale të autorizuar, mbi 1 250 kg, i cili duhet të realizojë një shpejtësi, mbi 80 km/orë.

11. Automjetet mësimore duhet të jenë të pajisura me pedale të dyfishta (gaz, freksion, frena), që përdoren nga vendi, ku qëndron instruktori, dhe në mes të instruktorit dhe drejtuesit të mjetit nuk duhet të ketë pengesa, që vështirësojnë ndërhyrjet e instruktorit, për të vepruar në drejtimin e mjetit. Automjetet mësimore duhet të jenë me pamje të jashtme të rregullt dhe në gjendje të mirë teknike, në të kundërt, nga kontrollorët e ministrisë, që mbulon veprimtarinë përkatëse, dhe organet e policisë rrugore, duhet të mbahet qëndrim deri në bllokimin e tyre, pa mbajtur përgjegjësi për vijueshmërinë e autoshkollës.

12. Mësuesit e teorisë dhe instruktorët e praktikës së autoshkollave duhet të plotësojnë kërkesat e nenit 121 të Kodit Rrugor, si dhe kërkesat e përcaktuara në udhëzimin e ministrit, që mbulon veprimtarinë përkatëse.

Miratimi i mësuesve të teorisë e i instruktorëve të praktikës së autoshkollave dhe pajisja e tyre me dëshminë përkatëse bëhen nga sektori përkatës, i DPSHTRR-së, pas testimit përkatës, sipas udhëzimit të ministrit, që mbulon veprimtarinë përkatëse. Dëshmia është e vlefshme për 5 vjet, me të drejtë rinovimi. Të drejtën e heqjes së dëshmisë e ka organi, që e ka lëshuar atë, kur shkelet në mënyrë të përsëritur legjislacioni rrugor ose kur shpërdorohet detyra. Dokumentet, që vërtetojnë plotësimin e kushteve të mësuesve të teorisë dhe të instruktorëve të praktikës, administrohen nga sektori përkatës i DPSHTRR-së.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1049, datë 16.7.2008

PËR RITJEN E FONDEVE TË MBROJTJES SOCIALE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Rritjen e fondeve të ndihmës ekonomike, në programin “Mbrojtja sociale”, të Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, me një shumë prej 150 (një qind e pesëdhjetë) milionë lekësh, për rritjen e masës së përfitimit të ndihmës ekonomike të familjeve në nevojë.

2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondi i kontingjencës, miratuar në Buxhetin e Shtetit të vitit 2008.

3. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe njësitë e qeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2008.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1050, datë 21.7.2008

PËR FURNIZIMIN E ANIJEVE TË PESHKIMIT ME GAZOIL, PA AKCIZË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 1 e, të nenit 19 të ligjit nr.8976, datë 12.12.2002 “Për akcizat”, të ndryshuar, të shkronjës “x” të nenit 199 të ligjit nr.8449, datë 27.1.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” dhe të pikës 7 të nenit 14 të ligjit nr.8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave dhe Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Furnizimi me gazoil, pa akcizë, i subjekteve, juridike apo fizike, të peshkimit, kryhet vetëm nga persona të pajisur me lejet përkatëse, në përputhje me ligjin nr.8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar.

2. Furnizimi me gazoil pa akcizë për subjektet e peshkimit realizohet vetëm nga magazinat doganore, me faturë tatimore shitjeje, me TVSH.

3. Subjektet, juridike dhe fizike, të peshkimit, të cilat përfitojnë gazoil, pa akcizë, janë të detyruara të:

a) pajisen me licencë peshkimi;

b) regjistrohen në organet tatimore dhe të shesin prodhimin e tyre me faturë tatimore, me TVSH.

4. Çmimi i gazoilit të shitur pa akcizë është çmimi, që magazina doganore, si furnizim bordi, zbaton ditën e furnizimit të subjektit të peshkimit, si çmim shitjeje, pa akcizë, por me TVSH. Kjo e fundit është e kreditueshme për blerësin e gazoilit.

5. Furnizimi i anijeve të peshkimit bazohet në normativat bazë të harxhimit të karburantit, sipas anijeve dhe llojit të peshkimit, në përputhje me shtojcën 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, por, në asnjë rast, vlera e përgjithshme e karburantit të furnizuar, gjatë një 6-mujori, nuk mund të jetë më e madhe se 80% e vlerës së përgjithshme të produktit të peshkimit, të shitur me faturë tatimore, me TVSH, gjatë kësaj periudhe. Në rast të kundërt, degët e tatim-taksave njoftojnë zyrtarisht subjektet furnizuese për ndërprerjen e furnizimit me gazoil, deri në përmbushjen e këtij kushti.

6. Furnizimi me gazoil, pa akcizë, për anijet e peshkimit do të realizohet sipas procedurave, të përcaktuara në udhëzimin e përbashkët të Ministrit të Financave dhe të Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, dhe sipas sasive, kushteve e kritereve të parashikuara në këtë vendim.

7. Lënda djegëse gazoil, pa akcizë, që do të përdoret për nevoja të peshkimit duhet të jetë e ngjyrosur me ngjyruetin fiskal të standardit të BE-së, (Solven Yellow 124, me emër shkencor N-etil-N-[2-[1-(2-isobutossietossi) etil]-4-(fenilazo)aniline). Niveli i ngjyrit është jo më pak se 6 mg/l gazoil dhe jo më shumë se 9 mg/l.

8. Ngjyrosja e gazoilit realizohet në magazinat doganore ose në autobotet, të cilat furnizojnë anijet e peshkimit, përpara procesit të plumbosjes së autobotit.

9. Policia tatimore ka të drejtë të kontrollojë serbatorët e automjeteve, pikat e tregtimit me pakicë të karburanteve, si dhe të gjitha subjektet, që nuk përfitojnë gazoil nga ky vendim, për karburant me ngjyrosës fiskal.

10. Në rast se vërehen shkelje të rregullave, për administrimin dhe menaxhimin e procesit, pavarësisht nga procedimi penal, organet tatimore kërkojnë zhdëmtimin e dëmit nga subjektet

përfituese, në përputhje me shkronjat “a” e “b” të nenit 44 të ligjit nr.8976, datë 12.12.2002 “Për akcizat”, të ndryshuar.

11. Ngarkohen Ministria e Financave, nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, dhe asaj të Tatimeve dhe Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave të ndjekin procedurat dhe rregullat e furnizimit me gazoil, pa akcizë, të anijeve të peshkimit.

12. Të gjitha vendimet e tjera, që bien në kundërshtim me këtë vendim shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet me hyrjen në fuqi të ligjit nr.9945, datë 26.6.2008 “Për një ndryshim në ligjin nr.8976, datë 12.12.2002 “Për akcizat””.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

SHTOJCË 1

NORMATIVAT TEKNIKE DHE TEKNOLOGJIKE TË KONSUMIT TË KARBURANTIT PËR ANIJET E PESHKIMIT

I. Peshkimi fundor – Pellagjik (Koeficienti Lit/Kg = 0.84)

A – anije peshkimi 150 hp

- Konsumi orar max. = $165 \text{ gr/hp/orë} \times 150 = 24.7 \text{ kg/orë} = 29.3 \text{ lit/orë}$
- Konsumi orar/mes. i shfrytëzimit = $29.3 \times 0.7 = 20.5 \text{ lit/orë}$

B – Anije peshkimi 300 hp

- Konsumi orar max. = $165 \text{ gr/hp/orë} \times 300 = 49 \text{ kg/orë} = 58.2 \text{ lit/orë}$
- Konsumi orar/mes. i shfrytëzimit = $58.2 \times 0.7 = 40.8 \text{ lit/orë}$

C- Anije peshkimi 400 hp

- Konsumi orar max. = $165 \text{ gr/hp/orë} \times 400 = 66 \text{ kg/orë} = 78.4 \text{ lit/orë}$
- Konsumi orar/mes. i shfrytëzimit = $78.4 \times 0.7 = 54.9 \text{ lit/orë}$

D- Anije peshkimi 600 hp

- Konsumi orar max. = $165 \text{ gr/hp/orë} \times 600 = 99 \text{ kg/orë} = 117.6 \text{ lit/orë}$
- Konsumi orar/mes. i shfrytëzimit = $117.6 \times 0.7 = 82.3 \text{ lit/orë}$

E- Anije peshkimi 1000 hp

- Konsumi orar max. = $165 \text{ gr/hp/orë} \times 1000 = 165 \text{ kg/orë} = 196 \text{ lit/orë}$
- Konsumi orar/mes. i shfrytëzimit = $196 \times 0.7 = 137.2 \text{ lit/orë}$

II. Peshkimi me rrethim

A- Anije peshkimi 80 deri 600 hp

- Konsumi orar max. = $165 \text{ gr/hp/orë} \times 300 = 49 \text{ kg/orë} = 58.2 \text{ lit/orë}$

- Konsumi orar/mes. i shfrytëzimit = $58.2 \times 0.50 = 29.1$ lit/orë

III. Peshkimi selektiv

A- Anije peshkimi 80 hp

- Konsumi orar max. = $165 \text{ gr/hp/orë} \times 80 = 14.4 \text{ kg/orë} = 17 \text{ lit/orë}$

- Konsumi orar/mes. i shfrytëzimit = $17 \times 0.7 = 12 \text{ lit/orë}$

B-M/Flluga peshkimi 40 hp

- Konsumi orar max. = $165 \text{ gr/hp/orë} \times 40 = 6.6 \text{ kg/orë} = 8 \text{ lit/orë}$

- Konsumi orar/mes. i shfrytëzimit = $8 \times 0.7 = 5.6 \text{ lit/orë}$

C-M/Lanca peshkimi 20 hp

- Konsumi orar max. = $165 \text{ gr/hp/orë} \times 20 = 3.4 \text{ kg/orë} = 4 \text{ lit/orë}$

- Konsumi orar/mes. i shfrytëzimit = $4 \times 0.7 = 2.8 \text{ lit/orë}$

D-M/Lanca peshkimi 10 hp

- Konsumi orar max. = $165 \text{ gr/hp/orë} \times 10 = 1.7 \text{ kg/orë} = 2 \text{ lit/orë}$

- Konsumi orar/mes. i shfrytëzimit = $2 \times 0.7 = 1.4 \text{ lit/orë}$

Në përlllogaritjet e konsumit faktik të karburantit për anije dhe forma të ndryshme peshkimi janë marrë në konsideratë:

1. Gjysmë orë ndezje e motorit në bankinë para nisjes për të arritur parametrat teknikë të punës, si dhe praktikë nisje.

2. Në Durrës e Vlorë, dy orë ecje e lirë deri në zonën e peshkimit dhe dy orë kthim në port.

3. Në Shëngjin dhe Sarandë, një orë ecje e lirë deri në zonën e peshkimit dhe një orë kthim në port.

4. 20% e kohës në peshkim, llogaritet në lëshim veglash peshkimi dhe virim.

5. 10% ecje e lirë, motori në minimum, grisje e karikim trate, kolaudim pajisje peshkimi etj.

6. Rreth 60% e kohë pune efektive, tralim.

7. Janë marrë në konsideratë edhe rastet e kthimit në port pa peshkim, për kohë të keqe, defekte teknike etj.

8. Të gjitha përlllogaritjet, kanë si qëllim të përcaktojnë vetëm konsumin orar të karburantit, e për rrjedhojë sasia e karburantit që do të rimbursohet del nga koha e punës faktike në det të anijes, shumëzuar me konsumin e aprovuar në orë të paraqitur më sipër.

Në përfundim përcaktimi i normativës së harxhimit të karburantit për anijet e peshkimit, është bërë në vija të përgjithshme mbi bazën e formulës:

$$K = 0.70 \times \text{HP (max)} \times \frac{S}{D} \times T$$

K → Konsumi i karburantit të motorit për një kohë të caktuar

0.70 → Koeficient mesatar i përdorimit të motorit

HP (max) → Fuqia maximale e motorit në HP (kuaj fuqi)

S → Konsumi specifik i motorit sipas llojeve në gr/hp/orë

D → Densiteti i karburantit = 0.84

T → Koha në punë e motorit, (e cila mund të zëvendësohet me distancën e përshkruar në milje, pjesëtuar me shpejtësinë në nyje të anijes)

VENDIM

Nr.1051, datë 16.7.2008

PËR MIRATIMIN E PUBLIKIMIN ZYRTAR TË NOMENKLATURËS SË KOMBINUAR TË

MALLRAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 1 e 12 të ligjit nr.9461, datë 21.12.2005 “Për nomenklaturën e mallrave dhe tarifën doganore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e publikimin zyrtar të nomenklaturës së kombinuar të mallrave, 2008, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për zbatimin e këtij vendimi.

3. Vendimi nr.574, datë 19.11.2002 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e nomenklaturës së kombinuar të mallrave”, dhe çdo dispozitë tjetër, që bie në kundërshtim me këtë vendim, shfuqizohen.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare dhe hyn në fuqi me miratimin e niveleve të tarifave doganore, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM

Nr.1053, datë 23.4.2008

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.787, DATË 14.12.2005 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, TË PROCEDURAVE DHE TË MASËS SË NDIHMËS EKONOMIKE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10, 19, pika 3, 20, pika 2, 29, pika 10, e 35 të ligjit nr.9355, datë 10.3.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.787, datë 14.12.2005 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

1. Pika 14 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“14. Për vlerësimin social-ekonomik të gjendjes së familjes apo të anëtarëve të saj, që kërkojnë ndihmë ekonomike, administratorët shoqërorë, në bazë të listave të aplikantëve, në bashki/komuna, kërkojnë informacionin e nevojshëm nga:

- a) zyra e punës, nëse janë të punësuar a punëkërkues të papunë;
- b) zyra e tatim-taksave, nëse janë subjekte të regjistruara në këto organe;
- c) Inspektorati Shtetëror i Punës, nëse rezultojnë të punësuar informalisht;
- ç) zyra e sigurimeve shoqërore, nëse përfitojnë pension pleqërie/familjar, trajtime të tjera të veçanta, sipas ligjeve të veçanta, apo janë kontribues, në skemën e sigurimit vullnetar;
- d) zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, nëse kanë në pronësi pasuri të paluajtshme;
- dh) zyra e regjistrimit të automjeteve, nëse kanë mjete/automjete motorike;
- e) seksionet pranë bashkive/komunave, si në atë të urbanistikës, tregut të lirë, transportit, kulturës dhe energjetikës, nëse janë subjekte të regjistruara pranë tyre.”.

2. Pika 19 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“19. Masa e plotë e ndihmës ekonomike, pavarësisht nga numri dhe përbërja e familjes, nuk mund të jetë më e madhe se 7500 (shtatë mijë e pesëqind) lekë në muaj.”.

3. Shkronjat “ç” e “d” të pikës 22, ndryshohen, si më poshtë vijon:

“ç) Të ardhurat nga toka, sipas kategorisë së saj, që sigurohen nga bimët e arave, vreshtat, ullishtat, pemëtaria, me përjashtim të tokës në proces shkrupëzimi, llogariten sipas koeficientëve të mëposhtëm:

Kategoria e tokës

Emërtimi	I	I	I	I	V	V	V	VII	IX-X
Koeficientët e të ardhurave lekë/m ² në vit	1 5	1 3	1 2	1 1	9 .5	8 .6	7 .7	5	3

d) Të ardhurat nga blegtoria, të diferencuara sipas zonave, llogariten sipas koeficientëve të mëposhtëm:

Në zonat fushore Të ardhurat nga 1 lopë = 15 dele/dhi=3 dosa=5 gica=20 zgjoje bletësh=96 000 lekë/vit
Në zonat kodrinore Të ardhurat nga 1 lopë =12 dele/dhi=3 dosa=5 gica=20 zgjoje bletësh =54 000 lekë/vit
Në zonat malore Të ardhurat nga 1 lopë = 10 dele/dhi=3 dosa=5 gica=20 zgjoje bletësh=15 000 lekë/vit

4. Kreu IV “Kushtëzimi i ndihmës ekonomike me punë e shërbime në komunitet”, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“KREU IV

KUSHTËZIMI I NDIHMËS EKONOMIKE ME PUNË E SHËRBIME NË KOMUNITET

24. Bashkitë/komunat e kushtëzojnë përfitimin e ndihmës ekonomike me punë dhe shërbime në komunitet. Projektet për kushtëzimin e ndihmës me punë apo shërbime në komunitet janë detyrues me kohë të pjesshme, por mund të jenë edhe me kohë të plotë pune.

25. Projektet e punëve në komunitet, me kohë të plotë, organizohen me një numër të kufizuar pjesëmarrësish, në varësi me mundësitë, që kanë komunat/bashkitë për të plotësuar pagën minimale të pjesëmarrësve dhe pagesën e kontributit për sigurimin e detyrueshëm shoqëror.

26. Paga e pjesëmarrësve për projektet e punëve në komunitet, me kohë të plotë, përbëhet nga fondet e ndihmës ekonomike, të llogaritura sipas strukturës, për çdo familje, por jo më shumë se masa e pagesës maksimale të ndihmës ekonomike. Pjesa tjetër e pagesës së pjesëmarrësve në punë komunitare, deri në nivelin e pagës minimale, dhe pagesa e kontributit për sigurimin e detyrueshëm shoqëror plotësohen me fondet e taksave vendore të bashkisë/komunës, që i organizon këto projekte.

27. Projektet e punëve në komunitet, me kohë të pjesshme, disa ditë në muaj, janë të detyrueshme të organizohen nga të gjitha bashkitë/komunat. Në këtë rast, bashkitë/komunat ftojnë të gjithë anëtarët e familjes, të aftë për punë, që bëjnë pjesë në skemën e ndihmës ekonomike.

28. Pagesa për projektet e punëve në komunitet, me kohë të pjesshme, është e barabartë me masën e ndihmës ekonomike, që i takon çdo familjeje, në përputhje me strukturën e anëtarëve të vet, por jo më shumë se masa e pagesës maksimale të ndihmës ekonomike. Fondet, që mbeten të lira, si rezultat i mospjesëmarrjes në punë të disa familjeve, i përfitojnë familjet, që marrin pjesë në këto projekte.

29. Familjet, që marrin pjesë në këto projekte, pas përfundimit të projektit, kanë të drejtë të riaplikojnë për përfitimin e ndihmës ekonomike, sipas legjislacionit në fuqi.

30. Familjet, nëse anëtarët e tyre, të aftë për punë refuzojnë të marrin pjesë në projektet e organizuara në punë komunitare, me kohë të plotë apo të pjesshme, largohen nga skema e ndihmës ekonomike. Bëjnë përjashtim nga ky përcaktim, familjet të cilat kanë anëtarë, persona, që edhe pse në moshë pune, kanë aftësi të kufizuar për punë, të përhershme apo të përkohshme.

31. Bashkitë/komunat për realizimin e këtyre projekteve, marrin masat e mëposhtme:

i) përcaktojnë numrin e personave të aftë për punë, për çdo familje;
ii) përcaktojnë personat me aftësi të kufizuar për punë, të përhershëm apo të përkohshëm, si dhe ato mbi moshë pune, që nuk kanë mundësi për të kontribuar në projektet për punë e shërbime në komunitet;

iii) identifikojnë fushat e ndërhyrjes me projekte pune, me kohë të pjesshme ose të plotë, brenda funksioneve të veta;

iv) përcaktojnë fondet nga burimet e taksave vendore, për projektet me kohë të plotë, për të mbuluar pagën minimale dhe sigurimet shoqërore;

v) përcaktojnë fondet e ndihmës ekonomike, për të gjithë pjesëmarrësit në projekte me kohë të pjesshme.

32. Këshilli i bashkisë/komunës miraton listën e personave, që do të marrin pjesë në punët komunitare, projektet e punëve komunitare, objektet, ku do të ndërhyhet, kalendarin dhe vëllimin e punimeve për projektet me kohë të plotë apo të pjesshme.

33. Efektet financiare, për vitin 2008 e në vijim, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti vjetor i Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, nga fondet e grupit 25, titulli 10 430, kap 1, artikulli 505 “Transferta të brendshme”.

34. Ngarkohen Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministria e Financave dhe njësitë e qeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 258 472 (Kryeredaktori)
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2008 është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 4.8.2008
Doli nga shtypi më 4.8.2008

Tirazhi: 3300 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja “Ilar”
Tiranë, 2008

Çmimi 44 lekë